

1 E martë, 21 maj 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
8 Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
10 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
11 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Mirëmëngjes, të gjithë. Vërej për procesverbal që të
14 akuzuarit, me përjashtim të z. Krasniqi, janë të gjithë të
15 pranishëm në sallën e gjyqit. Z. Krasniqi na ndjek përmes
16 videolidhjes dhe për këtë ka marrë lejen përkatëse.

17 Sot do fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
18 02540.

19 Përpara se të fillojmë, t'ju njoftoj lidhur me mocionin
20 që ka bërë Prokuroria për pranimin e provave të Dëshmitarit me
21 numër 00992, 01336 dhe 04824, në bazë të rregullës 154, që u
22 dorëzuan të enjten janë përsheptuar. Dhe Mbrojtja do t'u
23 përgjigjet të mërkurën më 22 maj, i lutem Mbrojtjes të na japë
24 edhe kohën që parashikon se i nevojitet për kundërpjetjet e
25 dëshmitarëve si dhe për përgjigjet që do të dorëzojnë në

1 kuadër të mocionit.

2 Me kaq mbyll urdhrin e Trupit Gjykues.

3 I lutem, Asistentes së sallës, të sjellë dëshmitarin
4 brenda.

5 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
7 Dëshmitar.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do t'ju
10 jap tekstin e betimit solemn të cilin duhet ta lexoni. Do t'ua
11 lexoj unë pjesërisht dhe do t'u përkthehet nga dikush dhe ju
12 lutem përsëriteni në gjermanisht. E kuptuat?

13 DËSHMITARI: [Përkthim] E kuptova.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e lexoj
15 unë: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
16 përgjegjësinë time ligjore.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
18 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Deklaroj
20 solemnisht se do të them të vërtetën.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Deklaroj solemnisht se do të them
22 të vërtetën.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Krejt të
24 vërtetën dhe vetëm të vërtetën.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Krejt të vërtetën dhe vetëm të

1 vërtetën.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe nuk do të
3 mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe nuk do të mbaj të fshehtë
5 asgjë për të cilën kam dijeni.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Pajtoheni me këtë betim?

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Pajtohem me betimin.

9 DËSHMITARI: DIETRICH JENSCH

10 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni.

12 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
13 mendohet se të zgjasë rreth tetë orë. Sikurse e dini,
14 fillimisht pyetjet do t'ua bëjë Prokuroria dhe më pas kanë të
15 drejtë dhe Ekipet e Mbrojtjes t'ju bëjnë pyetje. Po gjithashtu
16 edhe Gjykatësit mund t'ju bëjnë pyetje.

17 Prokuroria ka parashikuar dy orë për pyetjet e veta.

18 Ekipet e Mbrojtjes kanë parashikuar se u nevojiten 6 orë.

19 Inkurajoj palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e
20 kohës. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje shtesë nëse
21 përmbushen kriteret përkatëse.

22 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni qartë, me fjali të
23 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që
24 pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni në
25 mënyrë që të sqarohet. Gjithashtu na thoni ku e bazoni

1 njohurinë për faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë
2 pyetje.

3 Në qoftë se ZPS-ja ju kërkon të flisni për korrigjimet që
4 i keni bërë deklaratave tuaja, ju lutem thojeni me zë për
5 procesverbal se deklarata me shkrim, bashkë me korrigjimet
6 përkatëse, pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

7 Gjithashtu flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë
8 sekondash përpara se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë, në
9 mënyrë që t'ju kapin edhe përkthyesit.

10 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
11 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë tuaj
12 jashtë mureve të sallës së gjyqit. Në qoftë se dikush, jashtë
13 Gjykatës, ju bën pyetje lidhur me dëshminë tuaj, na vini
14 menjëherë në dijeni.

15 Ju lutem mos flisni më, nëse ju kërkoj këtë gjë dhe
16 gjithashtu pushoni së foluri nëse unë ngre dorën. Kjo do të
17 thotë që unë duhet të jap një udhëzim.

18 Nëse në ndonjë moment keni nevojë për pushim, na thoni në
19 mënyrë që të bëjmë organizimet përkatëse.

20 Dëshmitar, i kuptuat këto?

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. i kuptova.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Po fillojmë me pyetjet e Prokurorisë, që janë në të
24 majtën tuaj. Ju lutem dëgjojini me vëmendje.

25 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

1 Pyetje nga znj. Clanton:

2 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar. Jemi takuar. Unë quhem Sarah
4 Clanton edhe do t'ju bëj disa pyetje sot.

5 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Për qëllime planifikimi, do ju
6 lutesha të më tregoni nëse do bëjmë pushimin në orën 10.00?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do bëjmë
8 një pushim të shkurtër në orën 10.00.

9 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

10 PY. Dëshmitar, ju lutem për procesverbal na thoni emrin dhe
11 mbiemrin.

12 PË. Dietrich Klaus Jensch është emri im.

13 PY. Datëlindja dhe vendlindja juaj, ju lutem?.

14 PË. 18 qershor 1963, në Gjermani.

15 PY. Çfarë profesioni keni?

16 PË. Jam oficer i Ushtrisë Federale të Gjermanisë.

17 PY. Çfarë grade keni?

18 PË. Grada ime është lejtnant-kolonel.

19 PY. Po në qershor të 1999 çfarë grade ushtarake mbanit?

20 PË. Isha major.

21 PY. Dëshmitar, tani do flasim lindur me deklaratat që keni
22 dhënë më herët. A ju kujtohet që keni dhënë një deklaratë për
23 ish-Tribunalin e Jugosllavisë?

24 PË. Po, më kujtohet.

25 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Lutem Sekretarit të Gjykatës të

1 vendosë në ekran materialin me numër U002-6101 deri në U002-
2 6106 RED. Kjo është versioni në gjuhën gjermane. Dhe ju lutem
3 të vendosni dhe versionin në gjuhën angleze që mbaron me ET
4 RED2 në fund.

5 PY. A është kjo deklaratë juaj?

6 PË. Po, e kam përpara.

7 PY. Deklarata që kemi përpara mban datën 30 tetor 2001. A
8 është kjo faqja e parë e deklaratës suaj?

9 PË. Po, është faqja e parë e deklaratës sime.

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës
11 të shkojmë në faqen e fundit që mban numrin U002-6106.

12 Ju kërkoj falje, se kam disa probleme teknike. Kam nevojë
13 për pak ndihmë, ju lutem.

14 Shkojmë më poshtë në të majtë.

15 PY. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin majtas në faqe?

16 PË. Nënshkrimi në mes të faqes është nënshkrimi im.

17 PY. Faleminderit. A ju kujtohet që keni dhënë një intervistë
18 për Zyrën e Prokurorit të Specializuar në korrik të 2019?

19 PË. Po, më kujtohet.

20 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës
21 të vendosë në ekran materialin me numër 069539-TR Pjesa 1
22 *Revised* RED, faqja 1 në anglisht. Me të njëjtin numër, pra, ju
23 lutem dhe anglishtja mbaron TR-ET *Part 1 Revised* 1 RED.

24 PY. Dëshmitar, në ekranin përballë është faqja e parë e
25 intervistës suaj. A e njihni këtë si një pjesë të transkriptit

1 të intervistës për ZPS-në?

2 PË. Po, është deklarata ime.

3 PY. A ju kujtohet që u takuam dhe javën e kaluar, ju dhamë
4 edhe disa deklarata të TPNJ-së edhe tekstet e plota të
5 intervistës me ZPS-në, ju thamë t'i lexonit në mënyrë që të
6 bënit korrigjimet dhe sqarimet e nevojshme?

7 PË. Po, më kujtohet.

8 PY. A kujtohet që bëtë disa sqarime dhe disa korrigjime?

9 PË. Po, më kujtohet.

10 PY. A ju kujtohet që pasi mbaruam sqarimet dhe korrigjimet ua
11 lexuam dhe një herë, në fakt, ua lexoj përkthyesi në gjuhën
12 tuaj?

13 PË. Po, kështu është.

14 PY. Dëshmitar, duke marrë parasysh korrigjimet dhe sqarimet
15 që bëtë javën e kaluar, informacioni në deklaratën tuaj a
16 është i saktë dhe i vërtetë me aq sa keni ju dijeni dhe me aq
17 sa besoni ju?

18 PË. Po, deklarata me aq sa kam unë dijeni dhe me ndërgjegjen
19 time të plotë është e vërtetë.

20 PY. Dëshmitar, nëse përfshijmë të gjitha korrigjimet dhe
21 sqarimet që bërë javën e kaluar, deklaratat tuaja pasqyrojnë
22 saktësisht atë që a do të thoni edhe sot lidhur me ngjarjet e
23 pasqyruara lidhur me të?

24 PË. Po, përputhen me faktet.

25 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 8

1 pranimin e deklaratave të mëhershme të dëshmitarit dhe kanë
2 klasifikimin konfidencial. Numrat përkatës gjenden në
3 parashtrimin e protokolluar F02245, poshtë shënimi 47, pjesa 1
4 dhe 4 e intervistës së ZPS-së, si dhe deklarata e TPNJ-së.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm
6 Shënimin 1 po kërkoni që të pranohet?

7 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po ofroj Shënimin 1, po kërkohet
8 që të pranohet si provë. Fillimisht deklaratat, më pas provat
9 materiale dhe më pas shënimi përgatitor përkatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime?

12 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Materiali me numër U002-61, U002-616 RED plus përkthimin në
15 gjuhën angleze pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materialet marrin
17 numrin e provës materiale P1176. Desha t'ju thoja që ka dhe
18 përkthim në gjuhën shqip të këtyre materialeve, pra, është
19 gjermanisht, anglisht dhe shqip.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
21 pranohet dhe versioni në gjuhën shqipe dhe mban të njëjtin
22 numër.

23 Në rregull. Atëherë, materiali me numër 069539-TR Pjesa 1
24 *Revised* RED, anglisht, shqip pranohen.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali 069539-TR

1 Pjesa 1 *Revised* RED, plus shqipja dhe gjermanishtja e këtij
2 transkripti, marrin numrin e provës materiale P1177.1.

3 Dhe gjithashtu Prokuroria ka kërkuar që të pranohen dhe
4 pjesët 2 deri në 4.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kështu
6 është.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, Të gjitha
8 materialet me gjuhët e tyre përkatëse marrin numrin P1177.2,

9 Pjesa 3, sërish anglisht, shqip dhe gjermanisht marrin
10 numrin e provës materiale P1177.3.

11 Ndërsa Pjesa 4, me numrin e provën materiale P1177.4. Ju
12 faleminderit.

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do t'ju
14 kërkonim që të pranoheshin edhe provat materiale shoqëruese që
15 po ashtu janë të renditura në parashtrimin e protokolluar
16 F02245, poshtëshënimi 47, po kemi dy modifikime të vogla.
17 Fillimisht, nuk kërkojmë që të pranohen pjesët që mbajnë
18 numrin 05401003 sepse janë pranuar paraprakisht tërësisht. Dhe
19 meqë kjo video është pranuar në fakt e tëra, ne do të kërkonim
20 që tani të pranohet teksti i videos që mban numrin 054010-03-
21 TR-ET.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
23 kundërshtim për provat materiale shoqëruese?

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

25 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

2 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Provat materiale shoqëruese sipas numërtimit përkatës
5 pranohen.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 materiali i parë që gjendet në poshtëshënimin 47, me numër
8 U002-4989 deri në U002-4991, merr numrin e provës materiale
9 P1178.

10 Materiali i dytë U002-4992 deri në U002-4995 merr numrin
11 e provës materiale P1179.

12 Ndërsa teksti apo transkripti i videos që tashmë është
13 pranuar si provë materiale merr numrin P501.

14 Materiali i radhës që ka numrin 5005597 deri në 5005597
15 dhe përkthimi në gjuhën angleze 500559 deri në 550057-ET merr
16 numrin e provës materiale P1180.

17 Materiali me numër SITF0031163 deri në SITF0003167 dhe
18 dëshiroj të them diçka këtu, që në poshtëshënimin 47 Trupi
19 Gjykues ka pranuar vetëm faqet SITF0031164 deri në SITF003165,
20 faqet përkatëse do të marrin numrin e provës materiale P1181.

21 Dhe materiali i fundit SITF008892 deri në 00188901,
22 bashkë me përkthimin në anglisht dhe në shqip, do të marrë
23 numrin e provës materiale P1182.

24 Ju lutem dhe një herë t'ju pyes për klasifikimin e të
25 gjitha materialeve që sapo citova?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 11

1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Më jepni mundësinë t'ua
2 konfirmoj këtë gjatë pushimit, ju lutem.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
4 Vazhdoni.

5 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Tani kërkojmë që të paraqesim
6 dhe Shënimin Përgatitor 1 që mban numrin 120062 deri në
7 121083.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

9 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Materiali me numër 12062 deri në 121083 pranohet dhe merr
12 numrin përkatës të provës materiale.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi Përgatitor
14 numër 1 merr numrin e provës materiale P1183 dhe aktualisht
15 është i klasifikuar si konfidencial.

16 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po, është konfidencial.

17 Tani dua t'ju lexoj një përmbledhje të dëshmisë së
18 dëshmitarit.

19 Dëshmitari me numër 02540 u dislokua në Kosovë në qershor
20 të 1999 si komandant i forcave gjermane që ishte pjesë e
21 kontingjentit të KFOR-it. Dëshmitari me numër 02540 dhe
22 njësitit i tij ishin të vendosura në Prizren dhe ndër detyrat e
23 tyre ishte patrullimi dhe të trajtonin aspekte të sigurisë të
24 cilat po përjetonte popullata atje.

25 Dëshmitari me numër 02540 ka qenë i pranishëm kur u

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 12

1 bastisën ambientet që përdorte UÇK-ja. Në veçanti më 18
2 qershor 1999 ka qenë i pranishëm në ish-ndërtesën e MUP-it në
3 Prizren, ku drejtoi një operacion për të hyrë në ndërtesë për
4 të liruar personat e ndaluar dhe për të çarmatosur anëtarët e
5 UÇK-së që ishin të pranishëm. Ai pa persona të plagosur atje
6 dhe kërkoi mbështetje mjekësore nga njësitet e KFOR-it të
7 cilët ofruan ndihmë për këto lëndime.

8 Me kaq mbyll përmbledhjen time.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Vazhdoni tani me pyetjet që keni për dëshmitarin.

11 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, në deklaratat e mëparshme keni përshkruar
13 situatën kur shkuat në ndërtesë e MUP-it në qershor të 1999
14 dhe ku komunikuat me anëtarë të ndryshëm të UÇK-së. Për
15 transkript, kjo që sapo thashë gjendet në materialin P01176 në
16 faqet U002-6102 deri U002-6103 dhe në pjesën e parë të
17 intervistën për ZPS-në, në faqet 25 edhe 26.

18 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës
19 që të vendosë në ekran fotografinë që sapo u pranua me numrin
20 e provës material P01179 ose me ERN U002-4992.

21 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë fotografi, a është kjo një
22 fotografi që ju vetë ia keni dhënë TPNJ-së?

23 PË. Po, e njoh këtë fotografi.

24 PY. A e konfirmoni që ju vetë ia keni dhënë këtë TPNJ-së?

25 PË. Po, e konfirmoj.

1 PY. A mund të na e përshkruani këtë vendin që shohim në
2 fotografi?

3 PË. Po. Është fiks mu përballë ish-ndërtesës së MUP-it. Është
4 pjesa e hyrjes.

5 PY. Faleminderit. Më herët keni identifikuar dy persona në
6 këtë fotografi.

7 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Dhe kjo është dokumentuar në
8 provën materiale P0117.1, faqet 24 dhe 26.

9 PY. Dëshmitar, a mund të identifikoni ende personat me të
10 cilët keni folur kur keni shkuar fillimisht në ndërtesën e
11 MUP-it?

12 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Dhe Asistentja e sallës do t'ju
13 japi një laps që të bëni shënimin përkatës.

14 PY. Dëshmitar, përpara sesa ta shënoni në ekran, a mund t'i
15 thoni Trupit Gjykses kush janë personat e UÇK-së që keni
16 identifikuar ju më herët si komandant të UÇK-së me të cilët ju
17 keni folur?

18 PË. Po. Janë dy. Një në të majtë është një ushtar gjerman,
19 jam unë, në të djathtën time është një person me beretë të
20 gjelbërt, këtë person e kam njohur fillimisht dhe është një
21 person që është mbështetur te automjeti. Personi tek automjeti
22 me shenjën e UÇK-së. Nuk e di çfarë rripi krahu ka, po ky
23 është një nga udhëheqësit e UÇK-së.

24 PY. Atëherë, ju lutem, përdorni lapsin tani. Fillimisht
25 shënoni veten tuaj dhe vendosni numrin 1.

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 14

1 PË. [Shënon]

2 PY. Personi në të majtë që thatë që ka beretë të gjelbërt, ju
3 lutem atij vendosini numrin 2.

4 PË. [Shënon]

5 PY. Dëshmitar dhe personi i fundit që thatë është mbështetur
6 tek automjeti, vendosini numrin 3.

7 PË. Po.

8 PY. Dëshmitar, në intervistat e mëparshme keni folur për
9 personin që është mbështetur tek autovetura. Kur thoni personi
10 i mbështetur tek vetura, e keni fjalën për personin që i vutë
11 numrin 3?

12 PË. Po, për atë person e kam fjalën, për personin me numrin
13 3.

14 PY. Pra, personi i mbështetur tek vetura?

15 PË. Po, kështu.

16 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, do të
17 doja të paraqisja si provë këto fotografi me shënimin
18 përkatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtime?

21 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Fotografia me shënimet përkatëse që mban numrin e provës

24 P01176 pranohet.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Fotografia merr numrin

1 e provës materiale P1184.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Për procesverbal dhe mendoj se
4 duhet t'ju them që ky është imazhi me shënimin përkatës të
5 provës materiale P01179, jo P01176.

6 I lutem Sekretares të vendosë në ekran provën materiale
7 P0512 që ka numrin ERN 072507-02. Është një video rreth 30
8 sekonda e gjatë.

9 Ju lutem të shikojmë pjesën konkrete të videos që është
10 në minutën e 11, sekonda e 27 deri në minutën 12:03. Dhe do
11 kërkoja pastaj ta shikonin 30 sekonda, pastaj të ndalojmë
12 videon në mënyrë që dëshmitari të bëjë një identifikim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 [Luhet videoincizimi]

15 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju kërkoj falje, sepse në fakt
16 videon duhet ta kishim transmetuar pa zë.

17 PY. Dëshmitar, a e njihni vendin që e pamë në këtë video?

18 PË. Po, e njoh vendin. Është përpara godinës së MUP-it.

19 PY. Mbështetur në këto imazhe që sapo pamë, a jeni në gjendje
20 që të thoni se cila ka qenë data kur janë marrë këto sekuenca?

21 PË. Duhet të ketë qenë pas pasdites të 18 qershorit 1999.

22 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
23 Seancës që të shkojmë përsëri në të njëjtën video dhe pastaj
24 të ndaloj videon në minutën e 11 dhe në sekondë e 28. Ju lutem
25 kaloni pak më përpara dhe fillojeni që prej aty transmetimin.

1 [Luhet videoincizimi]

2 PY. Dëshmitar, tek imazhi që keni përpara në ekran, që
3 shpresoj që të jetë përsëri në minutën 11, në sekondën e 28,
4 besoj që shikoni disa ushtarë aty, apo jo, që janë persona që
5 kanë veshur uniformë. A e njihni ndonjë nga këta personat që
6 keni në ekran, Dëshmitar?

7 PË. Po. Në mes të fotografisë, është personi që unë në fakt e
8 kam identifikuar në fotografinë e mëparshme si personi numër
9 2.

10 PY. Për të shmangur ndonjë dyshim, ky është personi që kishte
11 këtë kapelën të vënë në kokë, apo jo, beretë, kështu ishte,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do i kërkoja Asistentes që t'i
15 japë diçka për të shkruar dëshmitarit, në mënyrë që të bëjë
16 identifikimin përkatës.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] [Shënon]

18 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Kryegjykatës, do të kërkoja që kjo të paraqitej si
20 provë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
22 kundërshtim?

23 PËRKTHYESJA: Palët nuk kanë kundërshtim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
25 ka kundërshtim nga palët kjo do të pranohet si provë

1 materiale.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
3 pjesa e shënuar që është marrë nga segmenti i provës materiale
4 P112 do të marrë numrin e provës P1184. Dhe do të doja
5 konfirmoja klasifikimin në qoftë se mund të klasifikohet si
6 publik apo jo?

7 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po, klasifikohet si publik.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Të dy fotografitë do të klasifikohen si fotografi publike.

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
11 seancës që tani të paraqesë në ekran provën ose dokumentin me
12 ERN 119101 deri në 119105 dhe të paraqesin faqen e fundit me
13 ERN 119105.

14 PY. Dëshmitar, do ju kërkoja që të shikonit fotografinë që
15 keni përpara në ekran dhe dua t'ju pyes, a e keni parë këtë
16 fotografi ndonjëherë?

17 PË. Po, e kam parë këtë fotografi edhe më herët.

18 PY. A është kjo një fotografi që ia keni dhënë Zyrës së
19 Prokurorit të Specializuar vetë?

20 PË. Po, unë e kam dhënë këtë fotografinë.

21 PY. A mund të na përshkruani se në çfarë vendi është bërë kjo
22 fotografi dhe cilët janë personat që janë personat që janë të
23 pranishëm nëse është e mundur?

24 PË. Sërish vendi është zona përpara godinës së MUP-it.

25 Ndërkohë që sa i takon personave që janë këtu: Shikoj në të

1 majtë një oficer të policisë ushtarake gjermane dhe janë dhe
2 dy oficerë të cilët unë nuk i njoh dot, nuk i identifikoj dot.
3 E gjithë kjo ka ndodhur përpara godinës së MUP-it. Mund të
4 them po ashtu, që makina e tipit xhip, që ka këtë KFOR-i të
5 shkruar me shkronja të madhaja, ka qenë makina që përdorja
6 unë.

7 PY. A mund të na shpjegoni Dëshmitar, se si ndodhi që armët
8 që i shikojmë këtu përdhe, pra, në tokë, kanë përfunduar aty,
9 a mund të na e shpjegoni këtë gjë?

10 PË. Po. Pasi kishim ndaluar -- jo, ndoshta jo ndaluar -- ta
11 formuloj ndryshe, pra, mbasi i kishim marrë liderët e UÇK-së i
12 kërkua që të dorëzonin në mënyrë vullnetare armët. Këtë gjë
13 ata e bënë. Dhe mund të shikoni që të gjitha dorëzimet janë
14 materiale të cilat ne i kemi gjetur, përveç armëve të cilat u
15 dorëzuan vullnetarisht, siç e thashë.

16 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja
17 që ky dokument të paraqitet si provë materiale dhe të caktohet
18 si material konfidencial.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
20 kundërshtim?

21 PËRKTHYESJA: Palët nuk kanë kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Dokument nga 119101 deri në 119105 -- ju kërkoj ndjesë, a mund
24 të ma thoni dhe një herë cila pjesë doni që të paraqitet si
25 provë materiale?

1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Pa problem. Është vetëm një
2 fotografi që është 119105.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
4 119105 prahet si provë materiale.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
6 kjo fotografi ka marrë numrin e provës materiale P1186.

7 Dhe në qoftë se nuk e kam gabim, imazhi i dytë i caktuar
8 që është prova materiale P1184 do ketë, pra, do kemi dy
9 dokumente të cilat kanë marrë numrin e provave materiale
10 përkatëse P1184 dhe P1185.

11 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Sekretare e Seancës do ju
12 kërkoja që të paraqisni në ekran provën P00726, që është ERN
13 106389-01. Është një video, një fragment video që zgjat rreth
14 40 sekonda. Mund të transmetohet në publik. Dhe do kërkoja që
15 të transmetohet për një minutë dhe 13 sekonda.

16 [Luhet videoincizimi]

17 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e thashë
18 gabim, kërkoj që të transmetohet deri në minutën e parë
19 sekonda e 30, jo e 13.

20 [Luhet videoincizimi]

21 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, a e njihni vendin që tregohet në minutën e
23 parë, sekondën e 40 të kësaj sekuence videoje?

24 PË. Po, e njoh këtë vend. Është përsëri pjesa e hyrjes në
25 godinën e MUP-it, ish-MUP-it.

1 PY. A njihni ndonjë prej ushtarëve gjermanë të KFOR-it tek ky
2 fragmenti që sapo patë?

3 PË. Po. Është Fritsch serxhent, që është një prej ushtarëve,
4 që ka qenë oficer i shtypit në kontingjentin gjerman të KFOR-
5 it.

6 PY. Dëshmitar, personat që janë pranë makinës që kanë veshur
7 uniforma të pjesshme në sfond, çfarë janë këta, janë ushtarë
8 të UÇK-së apo janë pjesëtarë të KFOR-it?

9 PË. Në sfond, personi që është mbështetur tek makina, pa
10 diskutim që ky është anëtar i UÇK-së. Përveç këtij, ka edhe
11 ushtarë të tjerë gjermanë që mund t'i shikoni në foto. Po
12 ashtu edhe tek pjesa e pasme, pranë pemës, ka disa ushtarë të
13 tjerë të UÇK-së që mund të shikohen në distancë.

14 PY. Mbështetur nga ajo çfarë ju kujtohet nga kjo skenë, këta
15 personat që ju thatë që ishit ushtarë të UÇK-së, pra, këta që
16 janë pranë pemës dhe personi që është mbështetur te makina, a
17 janë persona këto që ju besoni që kanë qenë të pranishëm në
18 godinën e MUP-it kur ju keni kërkuar boshatisjen e kësaj
19 godine më datë 18 qershor 1999?

20 PË. Po, këta janë këta persona, sepse të gjithë personat të
21 cilët janë përreth godinës janë personat të cilët janë ndaluar
22 nga ne.

23 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
24 seancës që të paraqesë videon nga minuta e parë deri në
25 sekondën e 12 në minutën e dytë, domethënë, për këtë sekuencë.

1 [Luhet videoincizimi]

2 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që e keni parë këtë video gjatë
4 seancës përgatitore përpara një jave?

5 PË. Po, e kujtoj. Edhe unë vetë, domethënë, dukem qartazi në
6 atë video, më kujtohet që e kemi parë para një jave.

7 PY. Në rregull.

8 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Tani do të kërkoj që të kalojmë
9 tek minuta e parë, sekonda e 19 e së njëjtës video.

10 [Luhet videoincizimi]

11 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Atëherë do të kërkoja që të
12 kalonim pak më përpara në video.

13 [Luhet videoincizimi]

14 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të ndalojmë këtu. A mund të
15 kthehemi gjysëm sekonde pas?

16 [Luhet videoincizimi]

17 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Në rregull. Këtu.

18 PY. Dëshmitar, ju sapo na thatë që e njihni veten tuaj në
19 këtë video. Tani a mund të na thoni në qoftë se njihni ndonjë
20 person që është i paraqitur tek fotografia e ngrirë në ekran?

21 PË. Po. Personi në të majtë që ka këtë orën e zezë, ky jam
22 unë.

23 PY. Po ndonjë person tjetër a e njihni në këtë imazh, në këtë
24 fotografi?

25 PË. Po. Personi që është në sfond është personi me të cilin

1 kam folur dhe ai më ka thënë, e mbaj mend që ishte komandanti
2 i zonës së Pashtrikut dhe e mbaj mend që fliste frëngjisht.
3 Ushtari në të djathtë është një oficer i policisë ushtarake të
4 cilit nuk ia di emrin.

5 PY. Po personi që ju thoni në të djathtë që është ushtar i
6 policisë ushtarake është ushtar i policisë ushtarake me KFOR-
7 informacioni gjerman?

8 PË. Po. Ushtari me këtë shiritin e bardhë në helmetën e vet
9 është anëtar i kontingjentit të KFOR-it, i kontingjentit
10 gjerman në KFOR.

11 PY. Dëshmitar, ju thatë përpara një sekonde që ju njihni një
12 person që është prezantuar si komandant i zonës së Pashtrikut
13 dhe që fliste frëngjisht. A mund të konfirmoni që ky personi
14 është ky personi që është në fillim fare të ekranit dhe që ka
15 këtë aparatin në dorë?

16 PË. Po, po, ky është personi që e kam njohur si të tillë.

17 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] A mund ta rishikojmë edhe një
18 herë këtë fragment? Atëherë do ju kërkoja që të shohim dhe një
19 herë nga minuta e parë, sekonda e 12 deri në minutën e parë
20 sekonda 14.

21 PY. Dhe do ju kërkoja që të përqendroheshit dhe të shikonit
22 atë çfarë ndodh në të majtë të ekranit.

23 [Luhet videoincizimi]

24 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, a patët mundësi që të shikonit një persona që

1 zbriti shkallën në këtë klip prej 2 sekondash që sapo pamë?

2 PË. Po. Ky ishte personi që sapo e identifikova si komandanti
3 i zonës së Pashtrikut. Ai është personi që po zbret shkallët.

4 PY. Ky është personi që juve e morët brenda godinës së MUP-it
5 dhe i treguat trupin e një personi të vdekur, apo jo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Mbështetur nga kjo çfarë keni parë në këtë klip, a mund
9 të na thoni se kur është marrë kjo sekuencë në raport me kohën
10 ose duke e krahasuar me kohën kur u prezantua ky personi që ju
11 thoni që ka qenë komandant i zonës së Pashtrikut dhe që ka
12 folur në frëngjisht me ju, a është e mundur ta identifikoni
13 këtë gjë?

14 PË. Po, kjo ka ndodhur më pas. Unë jam futur me të në
15 ndërtesë përpara skenës që neve sapo pamë në videoklip.

16 PY. Dëshmitar, --

17 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Atëherë përpara se të vazhdojmë
18 mund ta heqim këtë klip.

19 PY. Atëherë përsëri duke folur për godinën e MUP-it dëshiroj
20 që t'i hedhim një sy dëshmisë që i keni dhënë TPNJ-së që është
21 pranuar si pro vë materiale P01176.

22 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do kërkoja të kalonim në faqen
23 U002-6104 dhe kjo faqe të paraqitet në ekran. Të kalojmë pak
24 më poshtë në faqe.

25 PY. Dëshmitar, në ekran përpara keni dy paragrafë, do t'ju

1 tërhiqja vëmendjen që të shikonit këto dy paragrafë që janë
2 diku nga mesi i faqes. Thuhet:

3 "Pas pak kohe një komandant i UÇK-së arriti aty, të cilin
4 e kisha takuar në një takim të mëhershëm në Prizren. Ai mu
5 prezantua në frëngjisht si komandant i Pashtrikut. Ai më pyeti
6 mua se çfarë problemi kisha dhe unë i tregova atij personin e
7 vdekur dhe ai më tha diçka të tillë si 'katastrofë e madhe'.
8 Biseda kryesisht ndodhi në frëngjisht dhe pak në gjermanisht,
9 megjithatë e kuptova atë mirë. Ai më tha që kishte jetuar në
10 Zvicër për një kohë të gjatë dhe prandaj fliste kaq mirë
11 frëngjishten."

12 Ndërkohë vazhdohet më tej në paragrafin e radhës si më
13 poshtë:

14 "Koloneli Besch dhe gjenerali Von Korff duhet ta kenë
15 njohur këtë person sepse ai kishte qenë në negociatat e
16 mëparshme në ish-godinën e Progresit të mëparshme. Ai kishte
17 qenë në godinën e OSBE-së dhe më pas në brigadë e OPS-it në
18 Prizren."

19 Kur thoni që ai ka marrë pjesë në negociata në godinën e
20 Progresit për çfarë e keni fjalën konkretisht, Dëshmitar?

21 PË. E kam fjalën për periudhën mbasi është marrë godina në
22 kontroll.

23 PY. Çfarë ju kujtohet nga biseda me këtë person, domethënë,
24 ky personi që fliste frëngjisht, çfarë ju kujtohet lidhur me
25 të më pas çfarë ka ngjarë me të?

1 PË. Nuk mund t'ju jap asnjë informacion tjetër shtesë sepse
2 unë nuk është se kam qenë pjesë e këtyre negociatave, këtyre
3 bisedimeve vetë, megjithatë ajo çfarë mund t'ju them është që
4 e kam parë më herët përsëri përpara godinës së Progresit.

5 PY. Ku keni qenë juve, ku keni qenë i stacionuar kur e keni
6 parë përpara godinës së Progresit?

7 PË. Kam qenë brenda makinës time që ishte përpara ndërtesës
8 në fjalë.

9 PY. Çfarë keni bërë kur e keni parë?

10 PË. Kemi bërë fotografi personave që janë futur në godinë.

11 PY. A ju kujtohet a keni bërë një fotografi apo më shumë sesa
12 një?

13 PË. Më kujtohet që kemi bërë dy fotografi sepse ishin dy
14 persona që ishin gjithashtu në ndërtesën e MUP-it, për
15 shembull në qoftë se do të vazhdoni të lexoni më tej në këtë
16 dokument, do vini re që koloneli Bescht ka urdhëruar lirimin e
17 anëtarëve të UÇK-së. Duke marrë parasysh faktin që kishim një
18 person të vdekur dhe disa persona të marrë peng, unë e
19 konsideroja situatën si akt penal dhe doja që të dokumentoja
20 personat që ishin përgjegjës përmes fotografisë.

21 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që keni parë fotografi të këtyre
22 dy personave kur kemi folur bashkë në janar të këtij viti?

23 PË. Po. Më kujtohet qartë fotografia e parë. Ndërkohë sa i
24 takon fotografisë së dytë është pak më e paqartë. Megjithatë
25 më kujtohen të dyja fotografitë.

- 1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
2 seancës që të paraqesë në ekran dokumentin U002 deri në 4996
3 dhe U002-4997.
- 4 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet kjo fotografi si një prej
5 fotografive që përmendët që është marrë tek pjesa e parkimit e
6 komandës së brigadës, a ju kujtohet që i keni parë këto
7 fotografi edhe më herët?
- 8 PË. Po, më kujtohet kjo fotografi. Është fotografi e cila
9 është bërë përpara hyrjes së godinës, ka shumë të ngjarë që ta
10 kem bërë unë vetë fotografinë sepse duket sikur është
11 fotografi që është bërë nga vendi i pasagjerit tek makina ku
12 kam qenë unë i pranishëm.
- 13 PY. A është bërë kjo fotografi në kohën kur ju e keni kuptuar
14 që anëtarët e UÇK-së kanë ardhur për negociim?
- 15 PË. Po, është bërë një takim në ndërtesën e shtabit të
16 brigadës.
- 17 PY. Dëshmitar, ju thatë që në fotografinë që keni bërë keni
18 njohur dy persona nga godina e MUP-it. A e shikoni ndonjërin
19 prej këtyre dy personave të jetë i pranishëm në ndonjërin prej
20 këtyre fotografive?
- 21 PË. Po, njoh një person në këtë fotografi, që është personi
22 që është në sfond dhe që ka këtë rripin në krah.
- 23 PY. A mund të na e përshkruani sesi ju kujtohet ai në godinën
24 e MUP-it gjatë bastisjes, mund të na thoni diçka më shumë
25 lidhur me të?

1 PË. Kur kam mbërritur në godinën e MUP-it, ishte ky personi i
2 cili dukej sikur ishte person përgjegjës dhe unë mu duk si
3 person jobashkëpunues, që ishte shumë jobashkëpunues dhe që
4 nuk i përgjigjej fare pyetjeve të mia.

5 PY. Dëshmitar, a është ky një prej personave që ju
6 identifikuat më herët si një ndër personat që keni parë dhe që
7 keni njohur aty?

8 PË. Po, ky është personi, është i njëjti person që ishte
9 mbështetur në makinë në fotografinë e parë që më treguat.

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mund të kalojmë tek faqja
11 tjetër.

12 PY. Dëshmitar, a mund të na përshkruani rrethanat në të cilat
13 është bërë kjo fotografi?

14 PË. Po. Kjo fotografi është bërë menjëherë pas fotografisë së
15 parë që sapo pamë, pra, po vinte një grup tjetër njerëzish.

16 PY. Çfarë ju kujtohet lidhur me këta njerëzit e tjerë që po
17 vinin drejt godinës?

18 PË. Më kujtohet se kam njohur të paktën një person, një
19 individ të cilin e kisha parë dhe më herët dhe ky ishte
20 personi ose komandanti që fliste frëngjisht.

21 PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që në janar të këtij viti ju
22 është treguar kjo fotografi dhe fotografia tjetër dhe ju
23 pyetëm për sa i takon përshkrimin të tyre dhe ju na thatë që
24 cilësia e fotografisë së dytë nuk është shumë e mirë, a ju
25 kujtohet kjo, Dëshmitar?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 28

1 PË. Po, më kujtohet. Edhe prapë edhe sot e kësaj dite kështu
2 mendoj. Mendoj që është një fotografi jo e mirë në cilësi
3 megjithatë më kujtohet vendi ku është bërë fotografia.

4 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do kërkoja që
5 të paraqiteshin në prova materiale dy fotografitë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
7 kundërshtim?

8 PËRKTHYESJA: Palët nuk kanë kundërshtim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
10 ka kundërshtim nga palët, atëherë pranohen në prova materiale
11 të dy fotografitë që janë përkatësisht të identifikuar si
12 dokumentet U002-4996 deri në U002-4997.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, i
14 caktohet prova materiale P1187. A mund t'i klasifikoj si
15 publike apo konfidenciale?

16 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Provat materiale mund të
17 klasifikohen si publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Dokumenti 1187 do të klasifikohet si publik.

20 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që tani
21 të paraqesë në ekran provën materiale P00503, që është një
22 video me ERN 068357-01. Dhe prova materiale e pranuar zgjatë
23 nga sekonda i 10 deri në sekondën e 54.

24 Do kërkoja që të transmetohej nga sekonda e 10 deri në
25 sekondën e 11 dhe pastaj të ndalohej videoja.

1 [Luhet videoincizimi]

2 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ndaloni në sekondën e 11, ju
3 lutem.

4 [Luhet videoincizimi]

5 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Dëshmitar, a njihni godinën në këtë fotografi që
7 keni përpara?

8 PË. Po, e njoh. Ne e quanim këtë godinë si Shtëpinë e
9 Ushtarëve. Sesi quhej tamam nuk e di këtë gjë.

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do kërkoja që të transmetohej
11 tani deri në sekondën e 24 dhe pastaj të ndalohet aty.

12 [Luhet videoincizimi]

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Kemi kaluar më shumë sesa
14 ç'duhej. A mund të kalojmë mbrapsht në sekondën e 25, ju
15 lutem?

16 [Luhet videoincizimi]

17 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, a njihni ndonjë person këtu në këtë fotografi?

19 PË. Në imazhin ose fotografinë që kam përpara, njoh
20 komandantin që fliste frëngjisht.

21 PY. Është ky personi që njohët pak më herët, është personi që
22 paraqitet në fotografinë që keni bërë kur keni qenë i ulur në
23 makinën tuaj përpara godinës së Progresit, ky është i njëjti?

24 PË. Po, është i njëjti person.

25 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Tani do kërkoja që të

1 transmetohet edhe për dhjetë sekonda të tjera videoja deri në
2 sekondën e 35 dhe pastaj të ndalohej.

3 [Luhet videoincizimi]

4 ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë vend?

6 PË. Po. Është ish-godina e MUP-it përsëri.

7 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mirë le të vazhdojmë dhe
8 transmetojmë deri në sekondën e 45 këtë video.

9 [Luhet videoincizimi]

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ndalojeni, ju lutem.

11 PY. Dëshmitar, mbështetur në atë që mund të shikoni në këtë
12 fragment, pra, që patë atë godinën e MUP-it, a mund të na
13 thoni se kur është bërë ky filmi, është bërë përpara
14 bastisjes apo pas bastisjes më 18 qershor 1999?

15 PË. Është filmuar kjo pjesë përpara sesa të bëhej bastisja,
16 sepse në atë kohë godina nuk ishte marrë nën kontrollin e
17 KFOR-it.

18 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] E shikoj sesa ka shkuar ora,
19 kështu që do ishte më mirë që të bëjmë një pushim përpara sesa
20 të vazhdojmë me një çështje më të gjatë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
22 Dëshmitar, do bëjmë një pushim prej 15 minutash tani dhe sapo
23 të jemi gati do t'ju thërrasim përsëri që të vini në sallë.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 31

1 --- Seanca ndërpritet në orën 9.59

2 --- Seanca rifillon në orën 10.15

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për qartësi
4 të procesverbalit, në qoftë se s'ka ndonjë pyetje, mund të
5 japim emrin e personit që ishte komandant që fliste
6 frëngjisht. Në qoftë se të gjithë e dini identitetin e tij,
7 nuk ka arsye që të mos shënohet në procesverbal, që të jemi të
8 qartë.

9 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Besoj që do të ishte e
10 dobishme.

11 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Dëshmitari nuk e di emrin.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë
13 këtë. Por kemi informacion të mjaftueshëm që ta themi.

14 Ndonjë reagim tjetër? Kundërshtim nga dikush tjetër? Nuk
15 ka.

16 Në procesverbal do të shënohet emri z. Halitjaha si
17 personi komandanti që fliste frëngjisht.

18 Mund të sillni dëshmitarin në Gjykatë.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Z. Dëshmitar, jemi gati të vazhdojmë?

22 Mund të vazhdoni.

23 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Faleminderit.

24 A mund ta shfaqni në ekran ERN SPOE00347353. Në qoftë se
25 mund të na ktheni në faqen paraprake.

1 PY. Z. Dëshmitar, në ekranin që e shihni është një artikull
2 nga gazeta *New York Times* i datës 19 qershor 1999. A ju
3 kujtohet që javën e kaluar gjatë seancës përgatitore ua kemi
4 lexuar këtë artikull në gjuhën që kuptoni, në gjuhën tuaj?
5 PË. Po, më kujtohet.

6 PY. Nuk do t'ju kërkoj që të lexoni përmbajtjen e këtij
7 artikulli, po në qoftë se mund të zmadhojmë fotografinë.

8 Z. Dëshmitar, kur shohim fotografinë poshtë titullit
9 "Rebelët e Kosovës pushtojnë qytetet, Raportohet dhunë", a e
10 keni parë këtë fotografi më parë?

11 PË. Po, e njoh skenën. Kjo ka ndodhur pasi që ne kemi marrë
12 kontrollin e ndërtesës së MUP-it.

13 PY. A i njihni personat që janë këtu në fotografi?

14 PË. Nuk njoh asnjërin prej tyre, por shoh që është një ekip,
15 person i ekipit mjekësor gjerman, i cili po mat tensionin e
16 dikujt në krah dhe shoh gjithashtu valixhen e doktorit. Këtë
17 nuk e mban asnjë ushtar i rregullt, por e mban doktori i
18 ushtrisë.

19 PY. Do të doja t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë artikull.

20 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Do të doja të shfaqim të njëjtin
21 artikull në një version tjetër, mënyra sesi është shtypur pra
22 dhe ERN është 013435 deri në 013436.

23 PY. Z. Dëshmitar, nuk keni nevojë ta lexoni këtë. Unë do t'ju
24 lexoj pjesët relevante dhe do t'ju përkthehen këto në
25 gjermanisht.

1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë tek
2 paragrafi 7 duke filluar nga sipër, i cili fillon nga "Brenda
3 stacionit".

4 PY. Këtu thuhet:

5 "Brenda stacionit, trupat gjermane gjetën 15 persona të
6 cil;t qenë marrë si të burgosur, përfshirë edhe një të
7 moshuar, të cilin e gjetën të vdekur, të lidhur me pranga në
8 një karrige dhe të rrahur rëndë, sipas një zëdhënësi gjerman,
9 nënkolonel Dietmar Jeserich".

10 A është e saktë kjo që është raportuar këtu sa i takon
11 numrit të personave të mbajtur të ndaluar aty dhe personit të
12 vdekur që ishte i lidhur në karrige?

13 PË. Po, kjo është e saktë.

14 PY. A e njihni nënkolonelin Dietmar Jeserich?

15 PË. Po, e njoh Dietmar Jeserich në momentin që është
16 dislokuar aty dhe e kam takuar më vonë në Afganistan.

17 Gjithsesi edhe kur kam punuar në Ministrinë e Mbrojtjes, kam
18 pasur kontakte me të edhe atëherë.

19 PY. Këtu prezantohet si zëdhënës. A ishte ky pozicioni i tij
20 i saktë mesa ju kujtohet dhe me sa e dini?

21 PË. Po, ai ishte nënoficeri për shtyp i kontingjentit
22 gjerman.

23 PY. Nëse kalojmë në paragrafin më poshtë, thuhet:

24 "Njëri prej të burgosurve kishte shenja të kuqe në
25 kurriz, një i moshuar kishte një fashë në kokë dhe të çara në

1 fytyrë, ndërsa një tjetër tha se e kishin goditur me mjete të
2 mprehta në këmbë.”

3 Dëshmitar, a kishit dijeni që kishte të lënduar, të
4 plagosur në kushtet siç janë përshkruar këtu aty?

5 PË. Po. Nga ndërtesa e ish-MUP-it, nga ish-ndërtesa e MUP-it
6 dolën disa persona të lënduar dhe i pashë ato lëndime.

7 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë në tre
8 paragrafë më poshtë në fjalinë ku fillon me “Koloneli Rolf
9 Bescht”.

10 PY. Aty thotë:

11 “Koloneli Rolf Bescht, komandanti gjerman, thotë se
12 aleatët po merrnin kontrollin e stacionit të policisë për ta
13 bërë tërësisht të qartë që ne jemi forca e vetme, autoriteti i
14 vetëm në qytet’”.

15 Është kjo në përputhje me atë siç e keni kuptuar ju rolin
16 tuaj dhe detyrat tuaja në Prizren?

17 PË. Po, kjo ka qenë detyra që ne kishim për të rivendosur
18 rregull dhe siguri si e vetmja forcë e pranishme në terren.

19 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nëse kalojmë në faqen vijuese.

20 PY. Paragrafi i tretë nga fundi këtu, këtu thuhet që.

21 “Gjermanët u kishin dhënë kohë rebelëve deri në drekë që
22 të largoheshin nga stacioni i policisë por është pak kohë pas
23 kësaj, patrulla gjermane e udhëhequr nga Dietrich Jensch, pa
24 disa prej tyre ishin akoma aty. Stacioni pastaj është rrethuar
25 nga trupat gjermane. Rreth 15 të burgosur u liruan dhe disa u

1 trajtuan nga mjeku gjerman.”

2 A ju kujtohet kjo gjë lidhur me afatin kohor që i ishte
3 dhënë UÇK-së për të larguar nga ndërtesa e MUP-it?

4 PË. Nuk mund t'ju them 100 për qind, por më kujtohet që kur
5 kam arritur ishte dhënë afati kohor dhe ndërtesa nuk duhej të
6 ishte e zënë më gjatë.

7 PY. Përveç referencës së afatit kohor të drekës, a konfirmoni
8 që ajo që është shkruar këtu, përfshirë me emrin tuaj, lidhur
9 me veprimet që janë ndërmarrë nga ju dhe njësia juaj për të
10 liruar të burgosurit?

11 PË. Po, kur kam marrë, e konfirmoj. Kur kam arritur aty ishte
12 e qartë që ndërtesa ishte e zënë dhe ne i kemi dhënë fund
13 kësaj, këtij okupimi pra.

14 PY. A është e saktë që stacioni u rrethua shpejt pastaj nga
15 trupat gjermane?

16 PË. Po. Kur arrita aty në vend, ishte një autobлиндë aty me
17 tetë apo nëntë ushtarë. Nuk më kujtohet saktësisht. Po kemi
18 qëndruar aty pasiv edhe pse ndërtesa ishte e zënë.

19 Kam hyrë në kontakt me komandantin e UÇK-së. Dhe mendova
20 se gjërat ishit pak si të çuditshme. Dërgova ushtarët e mi në
21 ndërtesë. Ata më thanë që kishin gjetur pengje dhe pak më vonë
22 një person të vdekur. Pastaj kam kërkuar për përforcime dhe
23 kam urdhëruar ushtarët që të rrethojnë ndërtesën.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Dhe e dorëzojmë këtë artikull si

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 36

1 provë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
3 kundërshtim?

4 PËRKTHYESI: Nuk ka kundërshtime nga Mbrojtja.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti ERN
6 SPOE00347353 dhe gjithashtu 013435 deri në 013436 pranohen si
7 prova materiale, si dy dokumente të printuara alternative.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 për sa i përket dokumentit të parë SPOE00347352 deri në 353,
10 vërej se Prokuroria përmendi 353 që në fakt dokumenti që ajo
11 shfaqti në ekran ishte 352. A do të thotë kjo që do pranojmë
12 gjithë dokumentin në tërësi?

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ishte gabim nga ana ime. Do të
14 kërkojmë pranimin e dokumentit të plotë.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëhere ERN do të jetë
16 SPOE00347352 deri në 00347353 dhe do t'i jepet numri i provës
17 materiale P1188.1.

18 Dhe dokumenti i dytë 013435 deri në 013436 që është
19 përkthimi në shqip do të marrë provën P1188.2.

20 PY. Dëshmitar, në deklaratën tuaj para TPNJ-së që është
21 pranuar si prova materiale P01176 do të doja të shikonim në
22 faqen U002-6105, paragrafi 3.

23 Dëshmitar, në paragrafin 3, lexohet:

24 "Nuk e di se çfarë ka ndodhur me pengjet. E di që disa
25 prej tyre u larguan dhe disa prej tyre i kam takuar përsëri në

1 kampin e pranimit në ish-shkollën e muzikës. Njësia ime ishte
2 përgjegjëse për Mbrojtjen e asaj shkolle dhe ky vend ishte
3 pika e mbledhjes për refugjatët e grupeve të ndryshme etnike”.

4 E shihni këtë pjesë të deklaratës?

5 PË. Po, e shoh këtë pjesë të deklaratës sime.

6 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që më herët këtë ndërtesën të
7 cilën e keni quajtur ndërtesa e ish-shkollës së muzikës, pra,
8 keni qartësuar që ka qenë njëra prej ndërtesave që është
9 dorëzuar KFOR-it për të ruajtur peshkopin serb?

10 PË. Po, ka qenë njëra prej katër ndërtesave që janë dorëzuar
11 dhe mua më është caktuar përgjegjësia për këtë ndërtesë me
12 ushtarët e mi.

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Për nevoja të procesverbalit,
14 qartësimi gjendet në P01183, paragrafi 15.

15 Znj. Sekretare, a mund të shfaqni ju lutem dokumentin
16 SITF00189141 deri në SITF0189142. Nuk duhet të shfaqet për
17 publikun. Si dhe përkthimin korrespondues në anglisht.

18 PY. Z. Dëshmitar, ky është raport i situatës, raport i
19 gjendjes në terren nga policia ushtarake më 25-99 Prizren.
20 Pra, në atë shihet shkrimi me dorë:

21 “Shih gjithashtu raportin të gjendjes në terren të
22 policisë ushtarake 12/99 ...”

23 E shihni këtë?

24 PË. Po, e shoh.

25 PY. Dhe siç e shohim në krye të kësaj, dokumenti mban datën

1 23 qershor 1999. Dhe tema është:

2 "Zbatimi i detyrave nga policia ushtarake."

3 Dëshmitar, në rreshtin ku thuhet "Referenca", aty
4 shkruan:

5 "Alert ..."

6 PË. Po, kjo është shkurtesa për njësinë time, pra, që është
7 Njësia e Misilëve të Lehta Tokë-Ajër"

8 PY. Dëshmitar, kjo i referohet njësisë suaj si njësi e lehtë?

9 PË. Po edhe kjo është një mënyrë për ta thënë.

10 PY. Tani do të shohim paragrafin e parë. Nuk do ta lexoj
11 sepse mund të lexoj emrat, disa emra sepse jemi në seancë
12 publike.

13 Në paragrafin e parë thuhet:

14 "Rreth orës 15.00 [dy persona] që jetojnë aktualisht në
15 shkollën e manastirit në Prizren, kanë njohur z. Sami Kehapi
16 dhe komandantin e UÇK-së në Prizren, z. Nezir Kryeziu, përmes
17 dritareve të ... shkollës së manastirit. Ata thanë që janë
18 rrahur në mënyrë të përsëritur dhe keqtrajtuar nga ata kur
19 janë mbajtur në ish-ndërtesën e MUP-it."

20 Dëshmitar, ju kujtohet kjo që ju lexova në këtë raport?

21 PË. Po, më kujtohet.

22 PY. Në dokument origjinal gjerman i referohet vendit si
23 shkolla e manastirit. Tani që keni lexuar këtë raport për
24 refugjatët nga ish-ndërtesa e MUP-it, a është e mundur, a mund
25 të ndodhë që shkolla e muzikës mund të jetë, që është

1 përshkruar në deklaratën tuaj, mund të jetë edhe ky seminari
2 ose shkolla e manastirit?

3 PË. Kjo është e saktë. Në atë kohë nuk e dinim cili, çfarë
4 roli kishte kjo ndërtesë dhe çfarë roli, çfarë shkolle ishte
5 kjo dhe për këtë e keni quajtur dhe shkolla e muzikës
6 fillimisht edhe pastaj e kemi quajtur shkolla e manastirit.

7 PY. Dëshmitar, e keni parë këtë raport gjatë seancës
8 përgatitore që kemi bërë javën e kaluar?

9 PË. Nuk e kisha parë këtë raport përpara javës së kaluar. Nuk
10 kisha dijeni për të.

11 PY. A i njihni emrat Sami Kehapi dhe Nezir Kryeziu, komandant
12 i zonës së Prizrenit, komandant i UÇK-së në zonën e Prizrenit?

13 PË. Jo, këta nuk i njoh.

14 PY. Dëshmitar, në këtë raport që shohim thuhet se njësia për
15 mbrojtje ajrore është informuar se personat po merreshin në
16 një fugon transporti ngjyrë blu. Dhe kjo është në paragrafin e
17 dytë. Dhe njësia juaj i ka ndaluar këtë pra. A ju kujtohet kjo
18 ngjarje?

19 PË. Nuk më kujtohet kjo sepse nuk kam qenë i pranishëm kur ka
20 ndodhur.

21 PY. A ju kujtohen raste të tjera ku juve apo pjesëtarë të
22 njësisë tuaj kanë parë persona që merreshin me forcë dhe
23 vendoseshin në automjete?

24 PË. Më kujtohet një skenë. Një Golf ngjyrë e zezë dhe një
25 prift që është futur në këtë Golf. Kjo ka ndodhur disa qindra

1 metra përpara nesh dhe xhipit që kishim ne nuk kishte fuqi

2 motorike të mjaftueshme që ne t'i ndiqnim ata.

3 PY. Është e saktë që keni parë priftin që po e fusnin, duke e
4 futur në këtë automjet?

5 PË. Po, kjo është e saktë.

6 PY. Dëshmitar, në dy rreshtat vijues në këtë raport thuhet që
7 pjesëtarë të Njësisë Mbrojtjes Ajrore kanë ndaluar marrjen me
8 forcë të personave dhe pastaj kanë gjetur që njëri prej
9 personave, z. Sami Kehapi kishte pistoletën dhe xhepin e
10 pistoletës.

11 "Samit Kehapi është ndaluar nga aty dhe kontrolluar."

12 Dhe pastaj renditen materialet që janë gjetur dhe janë
13 marrë nga ai dhe thuhet:

14 "Megjenëse Sami Kehapi nuk ishte në listën e personave të
15 autorizuar, armët dhe municionet i janë sekuestruar dhe njësia
16 patrulluese e policisë ushtarake është njoftuar."

17 Ndalimi dhe kontrolli i personave të dyshimtë a ishte
18 pjesë normale e punës tuaj në atë kohë?

19 PË. Po, kjo ishte pjesë e detyrave tona të përditshme, pra,
20 kontrollimi i personave apo i automjeteve të dyshimtë apo që
21 ne kemi menduar ishin të dyshimtë.

22 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
23 faqen vijuese, ju lutem.

24 PY. Z. Dëshmitar, në pjesën e fundit të këtij raporti mbi
25 pjesën ku janë listat e emrave lexon:

1 "Për të qartësuar situatën, z. Sami Kehapi u dërgua
2 pastaj në bazën e ish-MUP-it dhe ju dorëzuar majorit Reiser".

3 A mund të sqaroni këtu për kë e keni fjalën kur flisni
4 për ish-bazën e MUP-it?

5 PË. Po. Kjo është ndërtesa që përshkruam në pjesën e parë të
6 marrjes në pyetje, ish-ndërtesa e MUP-it, ishte dhe burg në
7 atë kohë dhe mendoj që kjo ka qenë që me datë 19 qershor është
8 dorëzuar. Dhe majori Reiser ka qenë me shumë gjasë komandant i
9 policisë ushtarake në atë kohë.

10 PY. Kur thoni ndërtesa është dorëzuar, kujt i është dorëzuar?

11 PË. Është dorëzuar nga ne, nga njësia jonë, nga unë, të
12 nesërmen dorëzuar policisë ushtarake, pastaj ata e kanë
13 përdorur nga ajo ditë. Pra, më 18 e kanë përdorur ata, pra, më
14 18 qershor ne e kemi marrë kontrollin e ndërtesës. Më 19
15 qershor e kam dorëzuar unë atë ndërtesë.

16 PY. Kur jemi të qartë, kur flisni për policinë ushtarake,
17 bëhet fjalë policinë ushtarake të kontingjentit gjerman?

18 PË. Po, e kam fjalën për policinë ushtarake të kontingjentit
19 të KFOR-it gjerman.

20 PY. Rreshti vijues, thotë:

21 "Një pistoletë dhe municione u sekuestruan dhe u dorëzuan
22 në pikën e mbledhjes së armëve".

23 A keni dijeni ju për këtë pikën e mbledhjes së armëve?

24 PË. Po, kjo ka qenë në ndërtesën e Progresit, ish-ndërtesë e
25 UÇK-së dhe tani në këtë kohë ishte zyra kryesore e komandës.

1 Ku ishte një pikë grumbullimi, ku kam qenë vetë personalisht
2 disa herë për të dorëzuar armë.

3 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mund të kthehemi tek faqja e
4 parë, ju lutem. Dhe të shohim pjesën në fund të faqes.

5 PY. Dëshmitar, nga fundi i faqes thuhet që:

6 "Kur patrulla e policisë ushtarake arriti në vendin në
7 fjalë, atyre ju dha një listë e sendeve se ... që përfshinte
8 dhe 9 meshkujt që mund të dëshmojnë që z. Sami Kehapi dhe
9 Nezir Kryeziu ishin të përfshirë në krimet e përshkruara në
10 raport në 1999."

11 A ishte ky majori serxhent Horhold, dikush që ju e
12 njihni?

13 PË. Po, ka qenë pjesë, pjesëtar i njësisë time dhe ka qenë
14 bashkë me mu pjesë e këtij operacioni në vitin 1999.

15 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkojmë që të
16 dorëzojmë këtë dokument si provë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
18 kundërshtim?

19 PËRKTHYESI: Nuk ka kundërshtime.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
21 SITF00189141 deri në SITF00189142 pranohet.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këtij dokumenti do t'i
23 jepet numri i provës materiale P1189 dhe do të klasifikohet si
24 konfidencial.

25 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Për të trajtuar temën e radhës

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 43

1 do të kërkoja të kalojmë në seancë private.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

3 Sekretare, na kaloni në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Page 44

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Page 45

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 46

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 47

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 48

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje nga znj. Clanton

Faqe 49

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 Dëshmitar, tani kemi gjysmë ore pushim. Mos diskutoni me
15 askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshmie tuaj. Do të
16 rikthem këtu në orën 11.30. Tani mund të lutem dilni nga
17 salla.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
21 ndryshim për orarin për kundërpjetet?

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, unë nuk kam ndryshime.

23 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, ne kemi disa pyetje, po më
24 pak nga ç'kishim parashikuar më herët, rreth 20 minuta.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë e kam shkurtuar në mënyrë

1 të konsiderueshme kohën.

2 Z. BAIESU: [Përkthim] Edhe ne i kemi reduktuar pyetjet
3 tona mendojmë se nja 20 minuta qameti na nevojiten.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Shihemi në orën 11.30.

6 --- Pauza fillon në orën 10.59

7 --- Seanca rifillon në orën 11.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

9 Prokurore, dëshironi të sqaroni diçka lidhur me klasifikimin e
10 disa prej materialeve të pranuar?

11 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po, Kryegjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Në rregull. Për sa i takon
14 provës shoqëruese të parë që është prova P01178 me numër ERN-
15 je U002-4989 deri në U002-4991; kjo është një provë materiale
16 konfidenciale.

17 Sa i takon provës së dytë, që mban numrin P1179, U002
18 deri në 4992-U002 deri në 4995 është me klasifikim publik.

19 Besoj se e thashë këtë edhe më herët. Megjithatë për
20 procesverbal prova P00501 është publike.

21 Ndërkohë imazhi në provën P1180, që është me ERN 5005
22 deri në 597 [Sipas përkthimit] dhe versioni në anglisht do të
23 klasifikohet si publike.

24 Dy faqet që pranohen nga SITF 00031164 deri në
25 SITF00031165 që janë pjesë e provës materiale P01181, do të

1 klasifikohet si konfidenciale.

2 Ndërsa raporti që ka numrin e provës P1182 ose me
3 SITF00188892 deri në 00188901 RED2 duhet të klasifikohet
4 gjithashtu si konfidenciale.

5 Atëherë sa i takon çështjes tjetër që doja që të trajtoja
6 tani ka të bëjë me transkriptin e rishikuar për pjesën e
7 videos që u tregua përpara pushimit që është prova materiale
8 P513. Do ta përgatisim rishikimin e kësaj pjese sa më shpejt
9 të jetë e mundur dhe t'jua nxjerrim palëve.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Tani riklasifikimi duhet që të reflektojë përcaktimet e bëra
12 nga Prokurorja në kundërshtim të rasteve kur do të ketë ndonjë
13 kundërshtim nga palët. Megjithatë nuk duket se ka kundërshtim
14 nga palët, kështu që do i kërkoja Sekretares të bëjë
15 klasifikimet siç kërkohet nga Prokurorja.

16 Znj. Asistente, silleni dëshmitarin tani në sallë, ju
17 lutem.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
20 tani jemi gati që të vazhdojmë me kundërpyetjet nga palët. Do
21 të fillojmë së pari me Mbrojtjen e z. Thaçi.

22 Znj. Tavakoli, e keni ju fjalën.

23 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

25 PY. Mirëmëngjesi, zotëri. Unë quhem Nina Tavakoli dhe jam

1 përfaqësuese e z. Thaçi sot. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me
2 përvojën tuaj individuale kur keni mbërritur në Prizren në
3 1999, në mënyrë të tillë që ne të shikojmë të gjithë
4 kontekstin në të cilin keni parë gjërat, për të cilat dhanë
5 dëshmi për Prokurorinë më herët.

6 Është e vërtetë apo jo, që ju jeni vendosur në Kosovë,
7 jeni dislokuar në Kosovë më 12 qershor 1999?

8 PË. Nuk e mbaj mend në qoftë se ka qenë data 12 qershor apo
9 12 qershor, nuk jam 100 për qind i sigurt për këtë. Por ka
10 qenë rreth kësaj periudhe; është e saktë kjo.

11 PY. Dhe nëse s'gabohemi jeni larguar në datën 28 qershor apo
12 jo?

13 PË. Po, e saktë është kjo.

14 PY. Eprori juaj i drejtpërdrejtë në mënyrë të tillë që të
15 mund të sqarojmë për procesverbal, mënyrën e formimit ose të
16 eprorit tuaj të drejtpërdrejtë, pra, eprori juaj i
17 drejtpërdrejtë ka qenë Komandanti, Zëvendëskomandanti i
18 Brigadës Kolonel Bescht apo jo?

19 PË. Nuk është tamam kështu, sepse ka pasur dy linja të
20 strukturës së komandës. Së pari, ka qenë komandanti kombëtar
21 ku kam pas varësi, ai që ka qenë Gjenerali Von Korff dhe
22 pastaj ka qenë brigada operative.

23 Pra, Von Korff është Gjenerali, ndërkohë që Gjenerali Von
24 Korff ka qenë shefi i brigadës operative. Unë vetë i kam marrë
25 udhëzimet nga brigada operative. Megjithatë, kam qenë nën

- 1 komandën e komandës kombëtare. Është pak e vështirë për ta
2 kuptuar dhe për të bërë dallimin ndërmjet komandës operative
3 dhe kontrollit operativ. Është zhargon ushtarak ky.
- 4 PY. Z. Bescht apo Zëvendëskomandanti Bescht, a është nën
5 mbikëqyrjen ose nën varësinë e drejtpërdrejtë të von Korff-it?
- 6 PË. Po. Ishte zëvendësi, domethënë ishte personi i dytë ose
7 numri dy i brigadës.
- 8 PY. Në rregull atëherë. Besoj që mjafton me kaq shpjegimi.
- 9 Atëherë, tri apo katër ditë pas nënshkrimit të
10 Marrëveshjes së Kumanovës midis KFOR-it ka qenë pak a shumë 9
11 qershori apo jo? Domethënë, mbas marrëveshjes midis KFOR-it
12 dhe Ish-Jugosllavisë ka qenë diku nga 9 qershori apo jo?
- 13 PË. Po.
- 14 PY. A ju kujtohet në qoftë se pas marrëveshjes, a janë
15 tërhequr të gjitha forcat jugosllave pas kësaj marrëveshjeje?
- 16 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht se çfarë ka ndodhur. E di që
17 ka pasur një armëpushim të menjëhershëm dhe forcat ajrore ish-
18 jugosllave mendohej që të largoheshin menjëherë nga zona e
19 Kosovës; kjo ishte marrëveshja.
- 20 PY. Arsyerja se pse po ju bëj këtë pyetje është që në momentin
21 kur ju jeni futur në Prizren, që ka qenë dikur data 12 apo 13,
22 aty kanë qenë të pranishme ende forcat jugosllave, apo jo
23 Dëshmitar?
- 24 PË. Po, e saktë është kjo.
- 25 PY. Në deklaratën tuaj ju thoni që ushtria jugosllave dhe

1 njësitet e posaçme të policisë jugosllave ishin të pranishme
2 dhe në një rast ju keni thënë që kishte rreth 2500 burra që
3 ishin të mbledhur në një vend. Domethënë, kishte shumë forca
4 jugosllave që ishin akoma të pranishme në terren. A ju
5 kujtohet që e keni thënë këtë, Dëshmitar?

6 PË. Po, më kujtohet që ta kem thënë këtë. Dhe kjo është një
7 shifër që unë e kam vlerësuar vetë, sepse më vonë ka pasur
8 konvoja të veçanta nga Prizreni brenda ushtrisë jugosllave të
9 cilat, me të cilat ne i kemi shoqëruar njerëzit.

10 PY. Po keni bërë komentin që policia speciale jugosllave,
11 trupat e policisë jugosllave speciale jugosllave, sjellja e
12 tyre ishte e ashpër. Këtë vetë e keni thënë ju; ky është
13 formulimi që keni bërë ju, apo jo?

14 PË. Këto nuk ishin forca speciale të ushtrisë jugosllave, por
15 ishin forcat e policisë, MUP-i. Dhe sa i takon sjelljes së
16 tyre, domethënë, sjellja e tyre ishte e ndryshme nga sjellja e
17 forcave ushtarake. Sa i takon forcave ushtarake, më duhet të
18 them që ata kanë respektuar marrëveshjet dhe sa i takon
19 sjelljes së tyre, forcat e tyre kanë qenë shumë agresive.
20 Domethënë, me fjalë të tjera, sjellja e tyre ishte e ndryshme.
21 Domethënë, forcat ushtarake silleshin ndryshe nga një ushtar i
22 zakonshëm.

23 Për shembull, tani më kujtohet që në një moment jemi
24 hasur me një grup paramilitarësh 40 a 50 veta në një autobus
25 që ishin të armatosur rëndë, por ata nuk është se ishin as

1 pjesë e MUP-it dhe as pjesë e ushtrisë jugosllave, ushtrisë
2 jugosllave.

3 PY. Po ishin serbë besoj, apo jo? Kështu mendoni?

4 PË. Po, ishin serbë. Ishin në autobus dhe ne, kam përshtypjen
5 që ishim shtatë veta, ndërkohë që ata ishin nga 40 deri në 50
6 vetë. Por për shkak të sjelljes së tyre, unë u tërhoqa dhe nuk
7 doja që ta përkeqësoja situatën, sepse nuk mendoja se kishim
8 ndonjë shans që t'ia dilnim me ta.

9 PY. Mendoj që ju thatë që ditën e parë juve u zutë në një
10 shkëmbim, në një shkëmbim zjarri ndërmjet ushtrisë jugosllave
11 dhe UÇK-së, kur po përpiqeshit që të largonin, të evakuonit
12 bazën serbe, a ju kujtohet kjo; është e vërtetë kjo,
13 Dëshmitar?

14 PË. Po. Ne na u caktua detyra për evakuimin e tre posteve
15 serbe. Shkuam në Suharekë dhe atje kishte edhe tre automjete
16 të forcave jugosllave; kishte gjithashtu dhe automjete të
17 KFOR-it. U futëm në shkëmbimin e zjarrit dhe ishte e qartë që
18 ata nuk e kuptuam që ne ishim forca të KFOR-it.

19 PY. A do të pajtoheshit me zëvendëskomandantin e Brigadës, z.
20 Bescht që ka thënë këtë:

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për procesverbal jepet në
22 dokumentin 077406, Pjesa 1, faqja 4, rreshtat nga 19 deri 21.

23 PY. A pajtoheni me këtë? Më dëgjoni, Dëshmitar.

24 "Situata e sigurimit ishte e rëndë që në fillim. Kjo
25 shprehej në mënyrë të dukshme nga të shtënat e vazhdueshme

1 edhe gjatë kohës së natës. UÇK-ja po luftonte ndërmjet vetes
2 në atë kohë, por po luftonte edhe kundër serbëve”.

3 A do të pajtoheni me këtë përshkrim, Dëshmitar?

4 PË. Në qoftë se ata kishin përleshje ndërmjet njëri-tjetrit
5 UÇK-ja, këtë nuk e di. Nuk është se kam parë me sytë e mi
6 ndonjë të shtënë në atë kohë, kështu që nuk jam dakord, nuk
7 pajtohem me këtë deklaratë. Në fillim kishte një lloj vakumi
8 gjatë pak ditëve të para. Kishte ende forca të ish-ushtresë
9 jugosllave, ndërkohë që me kalimin e kohës gjithmonë e më
10 tepër ushtarët e UÇK-së u futën në zonë dhe ndërkohë u krijua
11 një lloj vakumi. Kështu që ne u përpoqëm që sa më shpejt të
12 ishte e mundur të merrnim kontroll të situatës.

13 PY. Do ta trajtojmë edhe çështjen e vakumit. Megjithatë, ju
14 përshkruat që ndërkohë që ju ndoshta nuk pajtoheni me Bescht-
15 in, ju në deklaratën tuaj keni përshkruar situatën si më
16 poshtë, pra, “Që ishte si një gjendje kaosi ligjore, mungesë e
17 tërë ligji në shumë prej zonave”. A pajtoheni me këtë?

18 PË. Po, sigurisht që pajtohem me të, sepse nuk kishte askush
19 atje, nuk kishte as forca policore, nuk kishte as poste
20 policie, nuk kishte, s’kishte asnjë njeri.

21 PY. Domethënë, po thoni që nuk kishte asnjë lloj
22 infrastrukture civile ose administrative, domethënë, nuk
23 kishte as polici, as forca ushtarake në kohën që u larguan
24 serbët. Këtë po thoni, Dëshmitar?

25 PË. Po, me KFOR-in kishte një strukturë ushtarake atje.

1 PY. Po në aspektin organik, jo, i takon, apo jo?

2 PË. Dhe Bescht e përshkoi atë si një anarki të përgjithshme.

3 A jeni, a pajtoheni me këtë?

4 PË. Jo.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull. Për procesverbal
6 është në dokumentin 077401 [Sipas përkthimit], Pjesa 1, faqja
7 4.

8 PY. Mandati juaj si KFOR ishte që të vendoset një lloj rendi
9 në situatën e krijuar dhe që të siguronit sigurinë e publikut
10 derisa prania e civilëve ose organet civile të mund të merrnin
11 këtë përgjegjësi në supet e tyre, a është e saktë kjo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Tani dëshiroj që të flasim pak lidhur me personat që kanë
15 qenë në Prizren. Domethënë, kush ka qenë në Prizren përveç
16 forcave jugosllave, policë dhe UÇK-së kur keni mbërritur ju.

17 Në deklaratën e dhënë keni thënë që në fillim fare jo
18 shumë shtetas ose qytetarë u kthyen, por ju thoni më tej që
19 gradualisht njerëzit filluan që të ktheheshin përsëri në
20 shtëpitë e tyre, a ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, më kujtohet. Gjithmonë e më tepër njerëz po
22 ktheheshin mbrapsht. Pra, gjithmonë e më shumë njerëz po
23 kalonin kufirin në anën e Kosovës. Pra, po kalonin nga
24 Shqipëria në Kosovë. Kjo ishte e dukshme edhe në rrugë, se
25 thjesht shihje më tepër njerëz të pranishëm në rrugë.

1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, thjesht
2 dua që të na thuhet pak më qartë sa i takon transkriptit të
3 referencave të Prokurorit. Thjesht, ju lutem, na jepni pjesën
4 e referencës për transkript për ta pasur më të qartë. Për
5 shembull, kur thoni, që keni thënë në deklaratën e
6 dëshmitarit, do ishte mirë që të thoni që në çfarë pjese të
7 deklaratës së dëshmitarit e ka thënë dëshmitari atje.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

9 PY. Tani ju keni qenë aty kur është bërë zhvendosja ose
10 dislokimi i civilëve, apo jo, dhe a mund të na thoni se sa ka
11 qenë numri i përgjithshëm i këtyre civilëve të zhvendosur ose
12 që erdhën në atë zonë?

13 PË. Në përgjithësi, në total nuk jua them dot. Nuk e
14 konfirmoj dot. Megjithatë, mund të them që kanë qenë disa
15 mijëra, por me saktësi nuk jua them dot se sa ka qenë kjo
16 shifër.

17 PY. Në rregull, mund t'ju ndihmoj unë, në fakt, sepse zyra e
18 OSBE-së, pra, kjo organizatë, OSBE-ja, ka thënë që ndërmjet
19 marsit dhe qershorit të '99-s forcat e ish-Jugosllavisë edhe
20 Serbisë kanë dëbuar me forcë rreth 18 633 [Sipas përkthimit]
21 shqiptarë të Kosovës dhe se mbi 90 për qind e tyre janë
22 zhvendosur deri në qershor të 1999.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Sa për referencë, bëhet fjalë
24 për dokumentin SITF00001529 deri në 00001530 [Sipas
25 përkthimit].

1 PY. Në Prizren OSBE-ja raporton që shifrat e hershme janë nga
2 15 000 deri në 20 000 refugjatë të cilët janë kthyer përditë
3 pas konfliktit. A keni parë ose në fillim ose gjatë kohës që
4 keni qenë atje, ndonjë shifër që i përngjan këtij përshkrimi
5 të bërë nga OSBE-ja?

6 PË. Po, e konfirmoj.

7 PY. Përveç kthimit të civilëve kosovarë, ndërmjet tyre kishte
8 edhe elementë kriminalë që vinin nga Shqipëria, a ishte e
9 saktë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po. Të paktën më kujtohen dy incidente ku kemi arrestuar
11 persona të cilët po vidhnin dhe grabisnin dhe ata mbaj mend që
12 të kenë thënë që kishin ardhur nga Shqipëria.

13 PY. Sepse, në fakt, i keni thënë Prokurorisë dhe për këtë
14 referenca është në provën materiale P1177.3 në faqen 18, dhe
15 këtu citoj që, shqiptarët kanë ardhur ndonjëherë, ishin me
16 uniforma, por ndërkohë kishin ardhur për të plaçkitur dhe për
17 të vjedhur dhe për këtë arsye kishin kaluar kufirin. A është e
18 saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po, është e saktë. Shpeshherë ka ndodhur që ne t'i kemi
20 kapur personat që kishte veshur uniforma gjermane me flamurin
21 gjerman dhe i kemi kërkuar atyre që të paktën të hiqnin
22 flamurët që kishin në uniformat e tyre, në mënyrë të tillë që
23 ata të mos identifikoheshin më si anëtarë të ushtrisë.

24 PY. Ne e dimë se KFOR-i gjerman ka mbajtur të ashtuquajturin
25 ditar të luftës, duke filluar nga 24 shkurti 1999 deri me 29

1 korrik 1999 dhe ky ditar apo ky dokument është nënshkruar nga
2 shefi i KFOR-it gjerman Brigadieri i Përgjithshëm von Korff.
3 Një kopje e këtij dokumenti na është dhënë nga Zyra e
4 Prokurorisë edhe neve.

5 Me sa e kuptoj unë, ky ditar lufte - megjithatë në qoftë
6 se nuk e kam kuptuar siç duhet më korrigjoni - pra, me
7 ç'kuptoj unë ditari është mbajtur për çdo minutë të
8 operacionit tuaj. Domethënë, çdolloj veprimi që ju keni bërë e
9 keni shënuar në atë deklaratë sipas kronologjisë së ndodhjes
10 së ngjarjeve. Domethënë kjo është deklaratë e Kolonelit
11 Bescht. Sa i takon funksionit të ditarit të luftës, a do
12 pajtoheshit ju me këtë deklaratë të bërë prej tij ose me këtë
13 mënyrë të mbajtjes së shënimeve në këtë ditar?

14 PË. Po, por jo 100 për qind, sepse jo të gjithë incidentet
15 janë përfshirë në atë ditar lufte. Unë, personalisht, së
16 bashku me ushtarët e mi, ne pas një jave mbasi kishin ndodhur
17 x aktivitete, mundoheshim që të mblidheshim me njëri-tjetrin
18 dhe të kujtonim se çfarë kishte ndodhur gjatë javës.

19 Megjithatë, ndodhte që të harronim gjëra të caktuara, si për
20 shembull, si Suharekën dhe ndodhte se kishim kaq shumë
21 veprimtari dhe kaq shumë aktivitete sa ishte e pamundur që të
22 mund të regjistrohej çdo gjë.

23 PY. E kuptoj. Megjithatë, ajo çfarë po mundohem të them unë
24 është kjo, që gjitha gjërat që janë regjistruar në këtë ditar,
25 pavarësisht që ndoshta nuk ishin të reflektuara të gjitha, të

1 gjitha ato që ishin të paktën në këtë ditar lufte, ishin të
2 sakta. Sepse ishin shënime të hedhura nga oficerët gjermanë,
3 apo jo?

4 PË. Kjo varet nga cilësia e ditarit të luftës. Në qoftë se
5 ditari është 100 për qind i sigurt apo jo, apo në qoftë se
6 është i saktë 100 për qind, unë nuk mund ta them këtë gjë.

7 PY. Është nënshkruar nga shefi i KFOR-it gjerman, domethënë,
8 dhe presupozojmë që informacioni të jetë, që është në këtë
9 ditar të jetë i saktë, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Kjo është diçka të cilën nuk e konfirmoj dot kështu. Mund
11 të ketë pasur, për shembull, të përfshira dhe mesazhe përmes
12 radios që nuk ishin të sakta ose të cilat më vonë, i kemi
13 konstatuar që nuk kanë qenë të vërteta.

14 PY. Në rregull. Tani në kundërpjetjen që kam për juve dua që
15 të shikojmë ca pjesë të ditarit me njëri-tjetrin. Kështu që
16 pjesa e parë që dëshiroj që të shikoni, domethënë nuk duhet të
17 tregohet në ekran për ta parë publiku.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për Sekretaren dokumenti
19 identifikohet si SITF00225092 deri në SITF00225184. Në faqen
20 290. Është e njëjta faqe si në versionin gjermanisht ashtu
21 edhe në atë në anglisht. Ju kërktoj ndjesë, e thashë gabim
22 numrin e dokumentit. Do ta them edhe një herë tjetër. Jo,
23 atëherë, numri i dokumentit në anglisht është i saktë,
24 ndërkohë që dokumentin në gjermanisht ka numrin e
25 identifikimit SITF00224836 deri në 00225261.

1 Na intereson që të shkojmë në faqen 80 [Sipas përkthimit]
2 290 ose identifikimi tjetër është 181005. Faqja 209. Kjo është
3 faqja. Në fund të kësaj faqe, ju lutem. Është e njëjta faqe,
4 209.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na jepni
6 numrin ERN, jo numrin në PDF?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk e kam këtë në versionin
8 gjermanisht. Kam vetëm thjesht numrin në PDF. Në qoftë se nuk
9 e gjeni dot mund ta lexoj fjalinë dhe mund të përkthehet në
10 mënyrë të drejtpërdrejtë.

11 PY. Atëherë në këtë dokument thuhet që në orën [Sipas
12 përkthimit] 181005 është:

13 "Raport nga KFOR në Reçe.

14 "1. Në Dragash në orën [Sipas përkthimit] 7056 thuhet që
15 ka ndodhur një plaçkitje që ka përfshirë forcat e armatosura
16 nga Shqipëria dhe pas plaçkitjes personat janë kthyer përsëri
17 në Shqipëri."

18 A ju kujtohet ndonjë gjë lidhur me këtë çfarë ka ndodhur?

19 PË. Unë nuk jam përfshirë fare në këtë incident. Nuk kam qenë
20 i dislokuar në kufirin me Shqipërinë, por kam qenë në Prizren.

21 PY. Domethënë ideja është që shqiptarët i kalonin kufijtë dhe
22 kishte edhe elementë kriminal, domethënë, ndërmjet personave
23 të kthyer. A e keni vënë re këtë gjë edhe në vende të tjera?
24 Kjo është pyetja.

25 PË. Po, e kam vënë re këtë gjë.

1 PY. Faleminderit. Pra, për ta përmbledhur situata në të cilin
2 jeni gjendur ju dhe trupat tuaj, domethënë, të bëj një
3 përmbledhje dhe pastaj më thoni në qoftë se kam të drejtë apo.
4 Pra, situata sipas meje është kjo që ishte periudha menjëherë
5 pas lufte, ishin pasojat e luftës që ishte një situatë e
6 komplikuar; ishin të pranishme forcat jugosllave dhe të UÇK-së
7 dhe kriminelët shqiptarë. Kishte shumë armë në qarkullim;
8 kishte mijëra civilë të cilët ktheheshin në shtëpitë e tyre
9 përditë dhe kishte një mungesë rregulli dhe rendi përpara sesa
10 ju të shkonit në Kosovë.

11 A është një përmbledhje e saktë kjo e situatës kur juve u
12 futët në Kosovë?

13 PË. Kur flitet për tri-katër ditët e para, po e mbështes këtë
14 që sapo thatë.

15 PY. Faleminderit. Me ç'kuptoju unë qëndrimi juaj është që pas
16 këtyre tri-katër ditëve situata nuk ishte më e tillë, sepse
17 forcat tuaja ia arritën që të vendosin ligjin dhe rendin.
18 Kështu? E kuptova siç duhet, Dëshmitar?

19 PË. Po. Pas kësaj periudhe ne krijuam struktura ose vende të
20 caktuara ku njerëzit që kapeshin dërgoheshin. Për shembull, në
21 ndërtesën e MUP-it nuk kishte më pika kontrolli të paligjshme
22 në fillim, në fillim ishin këto, por pas kalimit të këtyre dy-
23 tri ditëve nuk ishin më. Të paktën kjo ishte situata në
24 Prizren.

25 PY. Do të kalojmë dhe këtu. Atëherë këta refugjatë shqiptarë

1 të Kosovës që po ktheheshin në Kosovë pas luftës, ata u kthyen
2 në Kosovë, ndërkohë i gjetën shtëpitë e tyre të djegura, pjesa
3 më e madhe e tyre shtëpitë i gjeti të djegura, apo jo,
4 Dëshmitar?

5 PË. Nuk e konfirmoj dot këtë për Prizrenin. Në Prizren nuk
6 kishte shumë shtëpi që ishin djegur.

7 PY. Një oficer shtypi, Gjenerali Fritsch ka qenë në terren
8 kur keni qenë edhe ju aty, a është e vërtetë kjo? Ai ka thënë
9 që refugjatët u kthyen vetëm për të gjetur shtëpitë e tyre të
10 djegura dhe orenditë dhe gjërat e tyre të vjedhura dhe të
11 shkatërruara.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për referencë këtë gjë, ky
13 person e ka thënë në dokumentin 071142-071313 në faqen 071220.

14 PY. A pajtoheni me përshkrimin e tij, Dëshmitar?

15 PË. Jashtë Prizrenit, po. Edhe sa i takon plaçkitjeve edhe
16 kjo është e vërtetë. Megjithatë, ne nuk kemi pasur shumë raste
17 djegieje në atë kohë. Kjo ka filluar më vonë. Për shembull,
18 kam parë kur unë u ktheva në Gjermani më vonë që kjo të
19 ndodhte. Këtë e kam ndjekur nga televizioni.

20 PY. Po, poashtu ata gjetën anëtarë të familjes dhe shokë të
21 tyre që ishin vrarë nga serbët, apo jo Dëshmitar?

22 PË. Nuk e konfirmoj dot këtë. Unë nuk kam pasur asnjë kontakt
23 me person të ngjashëm. Kam pasur kontakt vetëm me një person
24 dhe në qoftë se e kuptoj siç duhet, ky person ishte një grua
25 serbe, bashkëshorti dhe kunati i së cilës ishin vrarë dhe që

1 kishin qenë në shkollën e muzikës. Ky është rasti i vetëm për
2 të cilin kam dijeni dhe nuk mund t'ju jap dot informacion
3 tjetër shtesë.

4 PY. Po na thua që nuk është se jeni në dijeni të ndonjë
5 vrasje të një shqiptari të Kosovës në Prizren, këtë po thoni
6 Dëshmitar?

7 PË. Unë nuk kam parë asnjë vrasje të tillë vetë. Sigurisht që
8 kam dëgjuar për krime lufte, por me përjashtim të asaj çfarë
9 kam përmendur pak më përpara nuk mbaj mend asgjë tjetër. Mbaj
10 mend që kam parë pak persona ose dy persona të vdekur, por nuk
11 e di se çfarë kombësie kishin këta persona.

12 PY. Më lejoni vetëm një çast ju lutem. Kërkoj ndjesë. Po
13 kërkoj statistikën. E gjeta.

14 Rreshteri Fritsch ka shënuar si në vijim?

15 "Sipas ekspertëve britanikë më shumë se 10 000 kosovarë
16 shqiptarë janë vrarë nga serbët ose kanë humbur jetën gjatë
17 fushatës së spastrimit etnik."

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe kjo mund të gjendet në
19 dokumentin 071142-071313.

20 PY. Dhe e keni dëgjuar ndonjëherë këtë shifër?

21 PË. Jo.

22 PY. Tani, ZPS-së i keni thënë që ka patur shumë veprime
23 hakmarrjeje kur janë kthyer shqiptarët e Kosovës, a është
24 kështu?

25 PË. Po, kam parë dhe kam qenë dëshmitar i disa prej tyre

1 vetë.

2 PY. Plaçkitje në veçanërisht në fillim, vrasje dhe djegie të
3 shtëpive dhe kjo ka ndodhur kryesisht pasi ju jeni larguar.

4 PË. Kur flasim për zjarrvënie ka pasur dy-tre raste, por më
5 pak sesa ato që kam parë pastaj më vonë nga Gjermania në
6 televizion, sepse kam parë më shumë kur jam kthyer.

7 PY. Ndoshta mund t'ju tregoj disa pjesë të këtij raporti të
8 KFOR-it apo ditarit të KFOR-it dhe për të parë nëse kjo
9 përputhet me atë që keni parë edhe ju.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
11 ekranin versionin gjermanisht edhe anglisht. Kalojmë
12 fillimisht te pjesa në faqen 260 që është SITF00225100. Në
13 qoftë se mund të kalojmë tek paragrafi, pra 131720Bqershor.
14 Është në fund e shoh.

15 PY. Këtu lexon:

16 "Gjendja në Prizren:

17 "Forcat e MUP-it janë angazhuar në plaçkitje të izoluara.
18 Popullsia është duke u kthyer kundër ushtrisë jugosllave dhe
19 po pengon tërheqjen e tyre, veprime hakmarrjeje, forcat
20 gjermane kanë gjithçka nën kontroll dhe po ndihmohet nga
21 popullsia".

22 A është kështu, siç ju kujtohet juve?

23 PË. Po, ka patur veprime plaçkitjeje. Më kujtohet një skenë
24 ku përfshiheshin ushtarët e ish-ushtrisë jugosllave që po
25 qëllonin të shtëna në ajër dhe një komandant major gjerman, z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 68

1 List, i cili dinte pak gjuhën vendore dhe arriti që të
2 qetësojë situatën. Pra, kishte një përballje mes pjesës
3 shqiptare të popullsisë dhe forcave jugosllave që po
4 largoheshin.

5 PY. Një shembull tjetër i plaçkitjeve.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kalojmë në faqen SITF00225126.

7 Dhe këtu kemi, pra, pjesën e shënuar në numrin 171630.

8 PY. Këtu lexohet "Raport".

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Pak më sipër, pra.

10 PY. Raporti nga Inf Bn.

11 "Në fshatin Mushtisht DN 9082 shtëpi që digjen në zjarr
12 dhe pesë persona që marrin pjesë në plaçkitje. Kur patrulla
13 arriti plaçkitësit u larguan".

14 Pra, këtu shënohet gjërat që ju keni konstatuar dhe keni
15 gjetur?

16 PË. Unë kam qenë përgjegjës për Prizrenin dhe kjo ka ndodhur
17 jashtë Prizrenit. Nuk mund ta konfirmoj këtë; nuk kam qenë
18 dëshmitar i kësaj.

19 PY. Në rregull. Vazhdojmë në tej.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndoshta referenca e fundit
21 lidhur me këtë faqen 318. 0022155158 [Sipas përkthimit] dhe
22 referenca është 231350.

23 PY. [Nuk ka përkthim]

24 PË. Plaçkitja, pa dyshim, ndërsa zjarrvënia nuk më kujtohet.

25 PY. Mund të mos pajtohem me këtë. Ju dhe rreshteri Fritsch

1 mund të mos pajtoheni me këtë dhe nuk e di a pajtoheni me atë
2 kur ai thotë që:

3 "Ka qenë relativisht kaotike ditët e parë. Jemi përpjekur
4 të vendosemi aty, të krijojmë mundësi në këto zona që të
5 krijojmë siguri dhe ka pasur incidente vrasjeje, zjarrvënie
6 dhe të tjera".

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Referenca është 017336 Pjesa 1,
8 faqja 7 [Sipas përkthimit].

9 PY. A pajtoheni me këtë analizë?

10 PË. Po. Në ditët e para, ditët e para ka qenë kaotike. Po.

11 PY. Faleminderit. Tani dua të lëviz në atë që UÇK-ja bënte në
12 atë kohë. Ju i keni thënë ZPS-së dhe kjo është në dokumentin
13 P1177.3 faqe 18, se në të njëjtën kohë kur ju jeni dislokuar
14 në përpjekje për të rivendosur rend, UÇK-ja në Prizren
15 përpiquej, u përpoq dhe dështoi që të merrte qytetin. A ju
16 kujtohet që keni thënë një gjë të tillë?

17 PË. Po, më kujtohet.

18 PY. Dhe se kjo ishte ndoshta, dhe them ndoshta, e natyrshme
19 që UÇK-ja të përpiquej të mbushte këtë boshllëk, sepse ata e
20 konsideronin veten si fitimtarët dhe ne sipas tyre ishte
21 derdhur gjaku i tyre dhe jo i NATO-s për të luftuar kundër
22 sulmit të agresionit serb. Dhe donin, pra, që të merrnin
23 përsipër fitoren.

24 PË. Detyra e KFOR-it ishte që të rivendoste sigurinë,
25 qetësinë, stabilitet. Pjesë e kësaj ishte marrëveshja e paqes

1 ku thuhej se KFOR-it ishte forca e vetme që garantonte
2 sigurinë.

3 PY. Po në atë fazë kur ju keni hyrë aty nuk ishte bërë
4 marrëveshja akoma për të çarmatosur UÇK-në, apo jo?

5 PË. Nuk mund t'ju them këtë gjë me 100 për qind, me siguri
6 100 për qind. Natyrisht që ka patur disa marrëveshje, ndoshta
7 për armëmbajtjen, disa afate kohore sipas së cilave vetëm
8 ushtarë zyrtarë me shirita në krahë lejoheshin që të mbanin
9 armë. Ky ka qenë një proces i zhvilluar në disa faza. Pra,
10 bëhej fjalë për të drejtat e njerëzve që ishin të pranishëm
11 aty, armë, leje etj. Kjo ka ndodhur relativisht shpejt, në
12 fakt.

13 PY. Në fakt, kjo ka, nuk ka ecur, ka, gjendja ka qenë e
14 bllokuar. Më 9 qershor Marrëveshja e Kum..., është firmosur
15 Marrëveshja e Kumanovës dhe forcat, tërheqja e forcave
16 jugosllave dhe armëpushimi i menjëhershëm. Pastaj më 12
17 qershor ju keni hyrë sipas autoritetit dhe kompetencave të
18 dhëna nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të
19 Bashkuara dhe pastaj deri me datën 21 qershor kur ndërmarrja e
20 demilitarizimit të UÇK-së është nënshkruar. Pra, këto kanë
21 qenë afatet kohore në cilat janë zhvilluar gjërat në nivel më
22 të lartë në Kosovë si vend. Ju kujtohet kjo?

23 PË. Nuk më kujtohet të gjitha këto hollësi. Ajo që më
24 kujtohet është që në një moment të caktuar dhe tutje nuk,
25 personat nuk lejoheshin të mbanin armë pa leje armëmbajtje dhe

1 nuk lejoheshin që të mbanin të okuponin ndërtesa të caktuara.
2 PY. E kuptoj këtë dhe do të futem në këto hollësi. Por po ju
3 sugjeroj që më vonë është bërë një marrëveshje vendore në
4 Prizren e cila pastaj është bërë në të gjithë Kosovën. Dhe do
5 t'i trajtoj këto më në hollësi.

6 A ishit në dijeni që gjatë kohës që ishit në Prizren
7 uniformat e UÇK-së shiteshin lirë, 50 EURO, në tregjet në
8 Kosovë, në Prizren, të cilat mund t'i blinte kushdo,
9 pavarësisht a ishin pjesëtarë të UÇK-së apo jo. I keni parë
10 këto uniforma në shitje?

11 PË. Nuk i kam parë në shitje, por kam parë njerëz që ishin të
12 veshur me uniforma të ndryshme, uniforma të UÇK-së, uniforma
13 të Ushtrisë Federale Gjermane ose edhe me uniforma zvicerane.

14 PY. Kominisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Drejtat e
15 Njeriut raporton në shtator se kjo periudhë, raporton për këtë
16 periudhë kohore dhe nuk e di a keni dëgjuar për këtë. Do t'jua
17 lexoj tani.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ai thotë:

19 "Disa viktimat të dhunës mbi bazë etnike kanë raportuar se
20 sulmuesit ndaj tyre përfshinin njerëz me uniformë, që mbanin
21 uniforma të UÇK-së. Megjithatë është e mundur që një pjesë e
22 madhe e dhunës të jetë thjesht e shkaktuar nga elementë
23 kriminalë që maskoheshin me uniformat e UÇK-së, kufij të e
24 hapur, ishin kufij të e hapur dhe kjo gjë ka mundur rritjen
25 në numër të madh të elementëve kriminalë, kryesisht nga

1 Shqipëria. Është konstatuar gjithashtu që uniforma të UÇK-së
2 janë në dispozicion dhe mund të blihen për 50 DM në Shqipëri
3 dhe se shqiptarë, shtetas të Shqipërisë që nuk kishin lidhje
4 me UÇK-në përdornin uniformat si pasaportë për të kaluar
5 sektorin gjerman, sektorin e KFOR-it në Kosovë”.

6 Keni dëgjuar për këtë?

7 PË. Jo, nuk kam dëgjuar për njerëz që blinin uniforma apo
8 çmimin që ju përmendët.

9 PY. Por nga kjo rrjedhë apo jo, që uniformat ishin në shitje
10 dhe se kushdo mund t’i blinte ato. Kur dikush kryente një krim
11 në emër, me uniformën e UÇK-së, nuk do të thotë që këtë e
12 kryente UÇK-ja. Nuk mund të jeni i sigurt.

13 PË. Sigurisht, keni të drejtë. Por njerëzit që kemi ndaluar
14 për plaçkitje - më kujtohen dy raste - këta njerëz na kanë
15 thënë që i kanë blerë këto dhe janë kthyer pastaj në burg.

16 PY. Kërkoj ndjesë, ndoshta përkthimi nuk ishte i qartë. “I
17 kanë blerë, pastaj janë larguar?”.

18 PË. Kemi ndaluar njerëz që kishin pjesë të uniformës, apo të
19 uniformave veshur, por të cilët natyrisht nuk ishin pjesë e
20 strukturave të pushtetit vendor.

21 PY. Faleminderit. Tani dua të kaloj tek incidenti te MUP-i i
22 datës 18 qershor.

23 A është e saktë apo jo, që kur keni arritur aty juve ju
24 është dukur që gjithë bodrumi i kësaj ndërtese në të kaluarën
25 kishte qenë burg jugosllav. Kështu i keni deklaruar ZPS-së?

1 PË. Unë e krijova këtë përshtypje pasi pashë ndërtesën nga
2 brenda, po.

3 PY. Ju përshkruani instrumente torture. Referenca për këtë
4 është dokumenti P1177.1 që ju keni gjetur aty, pra,
5 instrumente. Por thatë që nuk ishte e qartë nëse këto ishin të
6 UÇK-së apo të serbëve më herët që kanë në këtë bodrum. A është
7 e saktë?

8 PË. E saktë. Ne thjesht i kemi gjetur, nuk ishim në gjendje
9 të përcaktojmë se kujt ishin këto instrumente.

10 PY. Faleminderit. Tani e dimë që ju keni arritur te ndërtesa
11 MUP-it pas ngjarjeve. Pra, lidhur me personat që ishin të
12 mbajtur të ndaluar aty.

13 PË. E saktë.

14 PY. Pra, nuk e dinit që arsyen pse personat që janë mbajtur
15 të ndaluar aty janë, që janë dërguar aty, pse janë dërguar
16 aty. Nuk e dini arsyen?

17 PË. Saktë.

18 PY. Ne dimë që një person i moshuar, i vdekur është gjetur në
19 katin e parë.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
21 ekran dokumentin, provën materiale P00858, nuk duhet të jetë i
22 dukshëm për publikun, në faqen 16.

23 PY. Ky është raport nga zyrtari i lartë mjekësor i cili ka
24 bërë autopsinë e këtij mashkulli. Do të lexoj në procesverbal
25 vlerësimin në vend:

1 "Mavijosjet e gjetura, sipas mendimit tim, nuk përbëjnë
2 plagë vdekjeprurëse. Tabletat apo kokrrat e gjetura tregojnë
3 një problem të mundshëm kardiovaskular. Në këto raste një
4 vdekje e menjëhershme kardiale mund të jetë e, është e
5 mundur".

6 E shikoni këtë?

7 PË. Po e shoh.

8 PY. Tani dua të kaloj, të kthehem, pra, te pjesa e UÇK-së në
9 Prizren. Ju thatë, dhe kjo gjendet në pjesën 117.1, në faqen
10 21, edhe pse UÇK-ja nuk ishte organizatë me të vërtet
11 ushtarake, keni parë një lloj hierarkie, ju kujtohet kjo?

12 PË. Më kujtohet.

13 PY. Po ashtu keni deklaruar ZPS-së, dhe kjo gjendet në provën
14 materiale P1177.1 faqe 51, se komandant Drini ishte përgjegjës
15 për këtë zonën përreth Prizrenit dhe ishte pikë kontakti për
16 gjeneralin von Korff, komandanti i brigadës, dhe Koloneli
17 Bescht ishte zëvendësi i në anën gjermane, pra, që ka udhëtuar
18 me Drinin. A ju kujtohet kjo?

19 PË. Nëse thoni ka udhëtuar nuk më kujtohet në tërësi kjo. Ajo
20 që di unë ata që kanë qenë në kontakt dhe kanë biseduar me
21 njëri-tjetrin.

22 PY. Po dhe Drini ka qenë përgjegjës për zonën rreth
23 Prizrenit. Kështu keni thënë.

24 PË. Të paktën ishte përgjegjës për të. Nuk mund të them më
25 shumë se kaq.

1 PY. Në rregull. Gjithashtu keni deklaruar dhe kjo gjendet në
2 P1177.1, faqe 51 se në disa raste ai ka qëndruar në shtabin
3 gjerman dhe ju keni menduar, supozuar, se kjo ishte sepse ai
4 ishte personi, pika e kontaktit nga ana shqiptare e UÇK-së.

5 PË. Tani sidoqoftë ai ka qenë një prej kontakteve. Kanë qenë
6 disa kontakte.

7 PY. Por ai ka qenë personi, ai ka negociuar marrëveshje apo
8 jo, me dikë nga ana e KFOR-it me datën 17 qershor, që UÇK-ja
9 duhej të largohet nga të gjitha ndërtesat zyrtare dhe se ata
10 nuk lejoheshin më që të zinin këto ndërtesa. Këto i keni thënë
11 Zyrës së Prokurorit të Specializuar apo jo? Ju kujtohet?

12 PË. Po, këtë e kemi marrë vesh në takimin e mbrëmjes mbi
13 raportin e gjendjes në terren dhe mund duhet të ketë qenë data
14 17 qershor në mbrëmje në brigadë.

15 PY. Faleminderit. Dhe pastaj në artikullin e *New York Times*
16 që ju treguam më herët sot, flitet për një marrëveshje tjetër
17 e bërë nga Drini me KFOR-in. Dhe do t'ju lexoj tani tekstin.

18 "Një briefing në forcat aleate në mëngjes, gjatë mbledhjes
19 komandanti i trupave të forcave gjermane deklaroi një
20 marrëveshje se një marrëveshje ishte arritur me shefin e UÇK-
21 së rajonal, që njihej si komandant Drini, sipas së cilës nuk
22 do të lejoheshin personat që të mbanin armë në qytet pas
23 mesnatës dhe se aparati ushtarak do të shkrihej së shpejti.

24 "Sipas marrëveshjes UÇK-ja, me UÇK-në tani ne kishim
25 dritën e gjelbër për të çarmatosur këdo që sillej me armë në

1 qytet".

2 Ju kujtohet kjo?

3 PË. Jo në hollësi, por kur bëhet fjalë për përmbajtjen
4 padyshim që më kujtohet, siç e thashë më herët, neve na është
5 thënë që gjatë kësaj mbledhje të mbrëmjes kjo gjë. Dhe mbi
6 këtë bazë është bazohet edhe zbatimi i detyrave të mia.

7 PY. Dhe, pra, duket sikur gjendja e UÇK-së, në fakt, është
8 bërë një marrëveshje globale e përgjithshme që të çarmatosej.
9 Kjo është bërë më 21 qershor. Është e qartë se komandant Drini
10 pajtohej për gjëra të ndryshme me KFOR-in në nivel për disa
11 gjëra, në nivel vendor. Është e saktë?

12 PË. Nuk kam qenë i pranishëm. Tani nuk mund të jap një
13 vlerësim lidhur me këtë. Mund t'ju them, thjesht mund t'ju
14 tregoj për urdhrat që kam marrë unë në atë moment në kohë.

15 PY. Tani kalojmë tek urdhrat në atë kohë me datën 18. Pra,
16 Kolonel Bescht ju ka dhënë urdhrin që të ktheheni, që të
17 ktheni kartat e identitetit dhe të lejoni ushtarë të UÇK-së që
18 të largohen. Dhe keni menduar që ai kishte biseduar me Drinin
19 përpara që të bënte një gjë të tillë.

20 PË. Sidoqoftë, mendimi im ishte ndryshe. Besoj që duhet të
21 kishim marrë, shënuar identitetin dhe të dhënat personale të
22 këtyre personave.

23 PY. Sepse për shkak që ishit oficer gjerman ju keni ndjekur
24 zinxhirin komandues dhe jeni bindur urdhrave dhe keni kthyer
25 kartat e identitetit.

1 PË. Saktë.

2 PY. Kështu funksionin ushtria apo jo? Tani a do habiteshit në
3 qoftë se ju them që komandanti Drini, se vetë prania e tij në
4 Prizren pas vendimit të tij për t'u hequr forcat e tij në
5 qytet është marrë dhe është ndaluar në shkelje të
6 drejtpërdrejtë të urdhrit nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
7 të UÇK-së, Agim Çeku, i cili kishte urdhëruar atë që të mos
8 hynte në Prizren. E dinit këtë gjë?

9 PË. Nuk e dija këtë.

10 PY. Në fakt, ai vetë shiste mend dhe mund t'ju tregoj
11 artikullin për këtë.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund ta shfaqim
13 edhe një herë. Është prova materiale 1D00053. Ka dhënë një
14 intervistë për shtypin në gazetën *Bota Sot* më 19 janar. Në
15 qoftë se mund të kalojmë në faqen dy.

16 PY. Dhe ai vetë thotë aty në krye:

17 "Plani për lirim, çlirim e Prizrenit është bërë pa
18 pëlqimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe besoj që ka qenë veprim
19 efikas."

20 Kjo është thjesht për informacionin tuaj. Pra, Drini ka,
21 nuk është bindur Shtabit të Përgjithshëm që i kishte thënë të
22 mos futej në Prizren.

23 Po ashtu, a e dini ju që trupat, forcat e UÇK-së ishin
24 urdhëruar që të mos qëllonin me armë forcat serbe që ishin në
25 tërheqje në momentin që kishte hyrë KFOR-i. Ishit në dijeni

1 për këtë?

2 PË. Këto urdhra komanda nga UÇK-ja nuk i dija, nuk i dija.

3 PY. Dhe për procesverbal dua që të shënohet në procesverbal,
4 Hashim Thaçi ka informuar Sekretaren e Shtetit Madeleine
5 Albright në Kolonjë me 8 qershor se UÇK-ja do të nxirrte atë
6 ditë apo të nesërmen deklaratën e qëllimit, e synimit të saj
7 që mos sulmonte forcat serbe që ishin në tërheqje.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe ky dokument, për nevoja të
9 procesverbalit është SPOE00350943 deri në 00350950.

10 PY. Dhe mendoj që na thatë në fillim të dhënies së dëshmisë
11 suaj sot që ditën e parë kur ju u futët në Prizren ju u gjetët
12 në mes të të shtënave, me ushtrisë jugosllave dhe UÇK-së,
13 ndërkohë që po evakuonit serbët, ju po evakuonit serbët nga
14 një bazë, a është e saktë?

15 PË. Neve na ishte dhënë detyra të bëjmë një gjë të tillë. Nuk
16 kemi, nuk ishim në gjendje ta bënim, sepse në Suharekë kur
17 arritëm aty hymë aty dhe menjëherë u larguam nga fshati
18 përsëri, sepse nuk ishim të mbrojtur fare ndaj të shtënave. Më
19 kujtohet që ka qenë një zonë me zhurmë, e zhurmshme, mund të
20 kenë qenë granata dore, për shembull, apo të shtëna me pushkë
21 dhe pastaj kemi ndaluar këtë veprim, këtë operacion.

22 PY. Pra, në qoftë se është e saktë që UÇK-ja po qëllonte me
23 armë ndaj forcave serbe kjo është ajo që ju keni menduar që po
24 ndodhte apo jo?

25 PË. A mund ta përsërisni pyetjen ju lutem pak më saktë. Çfarë

1 ndodhi, kur ndodhi, se nuk e mora vesh mirë.

2 PY. A kuptuat ju që në atë incident, ajo që po ndodhte ishte
3 që UÇK-ja po qëllonte me armë ndaj forcave serbe?

4 PË. Po. Me sa duket nuk na kanë njohur si nuk na kanë
5 identifikuar si automjete të KFOR-it në atë konvoj. Pra,
6 kushdo qoftë që ta ketë dhënë këtë urdher, a ka qenë Drini, në
7 qoftë se ka qenë Drini. Kushdo që ka bërë këtë ka vepruar
8 kundër urdhrat, kundër asaj, premtimit që Hashim Thaçi i
9 kishte bërë znj. Madeleine Albright.

10 PË. Nuk i di as urdhrat dhe as marrëveshjet që janë bërë apo
11 nëse janë bërë. Kjo është pyetje që po bëni ju janë tani janë
12 në nivel të gabuar.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kemi nevojë të kalojmë në
14 seancë private.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
16 Sekretare na kaloni në seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly:

7 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

8 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Më dëgjoni?

9 PË. Po, ju dëgjoj.

10 PY. Unë quhem Annie O'Reilly dhe do t'ju bëj disa pyetje në
11 emër të Kadri Veselit.

12 Në rregull, Dëshmitar. Kam dy tema që dua të trajtojmë së
13 bashku. E para, lidhet me diçka që keni thënë sot paradite. Ia
14 keni thënë këtë koleges në të djathtën time dhe kjo është e
15 pasqyruar në faqen 48 të transkriptit të ditës së sotme. Në
16 rreshtin 16 thatë:

17 "Tani më kujtohet kur pamë një grup paraushtarak, nja 40
18 a 50, në një autobus. Ishin me armatime të rënda, por nuk
19 ishin as pjesë e MUP-it, as e Armatës Jugosllave".

20 A ju kujtohet ta keni thënë diçka të tillë?

21 PË. Po më kujtohet.

22 PY. Besoj se e mbani mend edhe datën kur ka ndodhur apo jo?

23 PË. Jo, emri nuk më kujtohet. Më kujtohet ajo skena me
24 autobusin dhe që fola me një person, sepse nuk kishte ushtarë,
25 edhe ishin, u sollën në mënyrë relativisht agresive.

1 PY. Në fakt për datën po ju pyesja, për datën. Në qoftë se ju
2 kujtohet. Në qoftë se nuk ju kujtohet nuk ka problem.

3 Sidoqoftë, kjo nuk ka qenë rasti i vetëm kur shfaqeshim
4 paraushtarakë në Kosovë, apo jo? Ka pasur situata të tjera kur
5 kishte paraushtarakë në Kosovë.

6 PË. Ata ishin paraushtarakë, paramilitarë që qartazi duket se
7 ishin nga ana e ish-Jugosllavisë. Ky ka qenë i vetmi incident
8 që më kujtohet. Kam parë disa herë në fakt persona të tillë.

9 PY. Do ju tregoj disa shënime nga blloku juaj në mënyrë që
10 t'ju ndihmoj me kujtesën.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Për këtë do të doja të shfaqja
12 në ekran materialin SITF00225092 anglishtja, faqja 60. Ndërsa
13 gjermanisht është SITF00224836, faqja 320 ose faqja që
14 përfundon me numrin 5155.

15 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj shënimin e katërt, 22 qershor,
16 dhe thuhet:

17 "Sipas informatave nga ish-komandanti i UÇK-së, Drini,
18 pranë zonës së Strepçës ka rreth 1 000 forca paramilitare
19 serbe që synojnë të hyjnë në Prizren sipas raporteve".

20 Ka pastaj një shënim urdhër:

21 "Të krijohet një CP... thuhet këtu... në mënyrë që të mos
22 anashkalohej dot, në mënyrë që të gjitha mjetet që do të hyjnë
23 në Prizren të kontrollohen për armë."

24 A ju kujtohet që kjo të ketë qenë rreth 15 apo 20 ditë
25 pasi keni hyrë ju?

1 PË. Jo.

2 PY. Po a ka qenë në zonën tuaj të përgjegjësisë me aq sa
3 besoni ju?

4 PË. Nëse ka qenë në zonën time të përgjegjësisë, atëherë zona
5 ime e përgjegjësisë ka qenë Prizreni. Por nuk mund t'ju them
6 asgjë lidhur me këtë incident dhjetë ditë më pas. S'më
7 kujtohet, sepse forcat e ish-Jugosllavisë dhe të MUP-it,
8 policia ishin larguar.

9 PY. Po, po, por nuk po flasim këtu për Armatën Jugosllave apo
10 policinë këto, por po flasim për forca paramilitare.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në rregull. Shohim në anglisht,
12 faqen 88 në fund. Ndërsa në gjermanisht është faqja 348 e
13 dokumentit.

14 PY. Dhe do të lexoj shënimin e fundit, 30 qershor 1999,
15 thuhet këtu:

16 "Oficeri ndërlidhës i UÇK-së pasi mësoi informacioneve të
17 zbulimit të UÇK-së se ka informacione, në, domethënë, ka
18 paramilitarë në kështjellën e Prizrenit që mbajnë të ndaluar
19 apo të burgosur 20 luftëtarë të UÇK-së. Janë të armatosur me
20 armatime të rënda".

21 Kjo ka ndodhur në kështjellën e Prizrenit më 20 qershor
22 [Sipas përkthimit]. A ju kujtohet ky incident?

23 PË. 30 qershor 1999. Unë kisha ikur në atë kohë nga vendi.

24 PY. Dhe pasi u largove nuk dëgjove gjë lidhur me këtë?

25 PË. Jo.

1 PY. E lemë këtë temë tani dhe flasim për këtë personin për të
2 cilin të kam bërë pyetje që ishte mbajtur i ndaluar në
3 ndërtesën e MUP-it më 18 qershor. Do t'ju pyes lidhur me disa
4 komente që ka bërë kolegu juaj, Dirk Menzel. Ju kujtohet Dirk
5 Menzel?

6 PË. Po, Dirk Menzel ka qenë pjesë e njësisë time. E keni
7 fjalën për ndërtesën e MUP-it apo ndonjë ndërtesë tjetër?

8 PË. Më falni, është gabimi im. Është rasti i incidentit në
9 godinën e MUP-i ku u gjet një person i prangosur me një dorë
10 te karrigia. Ju kujtohet ta keni parë Menzel, z. Menzel atë
11 ditë atje?

12 PË. Po, ishte në ndërtesë.

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Do doja të shfaqej në ekran
14 materiali me numër 072882-TR-ET Pjesa 2. Nuk është në
15 gjermanisht. Kështu që thjesht po e lexoj versionin që kemi.
16 Faqja 3, Pjesa 2, rreshti 21.

17 PY. Ai ka thënë:

18 "Më kujtohet që atëherë, pra, kur themi në këtë operacion
19 ushtarak, shkua nga një dhomë te tjetri, sepse nuk e dinim
20 ç'të prisnim. Pamë edhe këtë burrin, ishte ende gjallë. Nuk
21 ishte i vdekur. Atje ishte gjallë, i lidhur pas një karrige".

22 Dhe vijon në faqen 4, rreshti 9:

23 "Kur e lirua nga karrigia, mendoj se vdiq, vdiq gjatë
24 kësaj kohe, gjatë këtij procesi".

25 Dëshmitar, a ju kujtohet edhe ju në të njëjtën mënyrë

1 situata me këtë dëshmitar, - më falni - me këtë person?

2 PË. Jo. Unë këtë person e kam gjetur të vdekur. Kur shkova
3 unë atje personi ishte i vdekur.

4 PY. Po më duket se ju thatë që ju, ai kishte një dorë të
5 lidhur pas një karrige kur e patë ju, kështu?

6 PË. Po, po, kështu.

7 PY. Menzelit i kujtohet që ka qenë gjallë dhe ka vdekur kur i
8 hoqëm prangat. Juve ju kujtohet ndryshe që ai ishte i vdekur
9 kur e patë ju. Kështu?

10 PË. Unë kam shkuar në ndërtesë pas Menzelit. Menzeli më
11 raportoi dhe më tha diçka po ndodh këtu dhe pas kësaj hyra unë
12 në ndërtesë, kështu që kaloi pak kohë ndërmjet kësaj suate.

13 PY. Në rregull, Dëshmitar. Do shohim një dokument tjetër.
14 Është një intervistë me Dr. Schreckenbauer që besoj që ka qenë
15 pranë njësitit tuaj si mjek.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk kanë qenë pjesë e njësitit
17 tim, ka qenë doktor në brigadë, pranë brigadës.

18 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë na
19 nevojitet ERN-ja e intervistës së tij që mban numrin 071320,
20 në faqen 27 në anglisht dhe të njëjtën ERN ka edhe
21 gjermanishtja dhe po ashtu është në faqen 27.

22 PY. Kjo ka të bëjë me përfundimet që jua treguan edhe më
23 herët.

24 "Sipas vlerësimit tuaj në fund të raportit, pra, raportin
25 e patë më herët, Dëshmitar, thuhet që lëndimet nuk ishin

1 fatale, por që mund të ketë ndodhur një sulm në zemër". A mund
2 të na shpjegoni si dolët në këtë përfundim?

3 Përgjigje:

4 "Lëndimet në trup nuk ishin aq të rënda sa për të
5 justifikuar vdekjen. Unë kam shënuar në raportin tim se shkak
6 i saktë i vdekjes mund të përcaktohet vetëm përmes një
7 autopsie, për shkak të moshës së thyer të personit. Është e
8 qartë që mund të ketë pas edhe një shkak tjetër për vdekjen.
9 Lëndimet tek personat e tjera që kishin lëndime ishin të
10 ngjashme për nga natyra dhe për nga shkalla me ato që kishte
11 dhe personi që vdiq dhe as në rastin e tyre ato nuk ishin
12 vdekjeprurëse, nuk u shkaktuan vdekjen."

13 Dëshmitar, a keni ndonjë arsye ju për të kontestuar këtë
14 përfundim mjekësor, sa i takon shkakut të vdekjes së këtij
15 personi?

16 PË. Nuk është vendi im të vlerësoj përfundimet e një mjeku.
17 Në qoftë se është një raport, një autopsi shkon përtej
18 kompetencave të mia kjo.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
22 Mbrojtja e Selimit.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, vetëm një
24 çast ju lutem.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

1 Z. ROBERTS: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Geoff Roberts dhe jam
3 Avokati i z. Selimi. Kam shumë pak pyetje që do t'i
4 përfundojmë brenda 15 minutash. Kështu që dëgjoni pyetjet e
5 mia me vëmendje dhe gjithashtu siç keni bërë deri tani,
6 përgjigjuni shkurt. Nëse nuk kuptoni diçka më thoni.

7 Ne e dimë që ju keni qenë në Kosovë nga data 12 ose 13
8 qershor deri në 18 qershor dhe ju këtë e konfirmuat dhe roli
9 juaj ka qenë i bazuar në Rezolutën e Këshillit për të
10 rivendosur rendin publik deri në momentin që do të vinte
11 prania ndërkombëtare. Më falni, nëse do të, deri në momentin
12 që do të formohej qeveria [Sipas përkthimit]

13 PË. Po.

14 Z. ROBERTS: [Mikrofoni çaktivizuar]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
16 prisni, z. Roberts, që të përfundojë përkthimi.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kërkoj falje. Nuk e dija që po
18 përkthehej ende.

19 PY. Siç e pamë edhe në artikullin e gazetës që patë më herët,
20 është e *New York Times*. Është 18 qershor data. Është prova
21 materiale P1188.2. Është një citim këtu nga një komandant
22 gjerman Rolf Bescht, ku thuhet se "gjermanët po siguroheshin
23 që të ishin i vetmi autoritet në qytet".

24 Kjo përputhet edhe me rolin që mendonit se kishit ju, apo
25 jo?

1 PË. Kjo ka qenë detyra ime.

2 PY. Dhe ju duhet t'ia tregonit të gjithëve këtë që ju ishit
3 atje dhe ju ishit i vetmi autoritet për të kryer detyra
4 policore. Kur them ju e kam fjalën për KFOR-in gjerman në
5 përgjithësi.

6 PË. Po.

7 PY. Dhe ju kishit policë ushtarakë të konsiderueshëm pranë
8 KFOR-it. Kemi parë edhe fotografi që kishin këto fashat e
9 bardha rreth helmetave. A tregon kjo në fakt që kishit një
10 numër të konsiderueshëm ushtarësh?

11 PË. Po, numër i konsiderueshëm nuk mund ta them me siguri se
12 nuk e di sa ishin saktësisht. Po ama nuk ishin të mjaftueshëm.
13 Sepse disa merreshin me eksplozivët, disa ishin forca të
14 sigurisë, nuk ishin të mjaftueshëm në numër.

15 PY. Sidoqoftë ju e kishit bërë të qartë që çdo veprimtari
16 policore ishte përgjegjësia juaj, përfshirë hetimin e
17 vendngjarjeve, të flisnin me persona të dyshuar apo çdo formë
18 tjetër hetimi. Kjo ishte përgjegjësia juaj ekskluzive, apo jo?

19 PË. Jo, nuk është e saktë. Përgjegjësia ime ishte të
20 sigurohesha që rendi publik të ishte i sigurt dhe policia
21 ushtarake pastaj dhe t'jua jepja këtë policisë ushtarake në
22 mënyrë që të bënin raportet përkuese.

23 PY. Më falni, duhej të kisha qenë unë më konkret. E kisha
24 fjalën që policia ushtarake e kishte këtë autoritet dhe ju u
25 ofronit ndihmë në kryerjen e detyrës.

1 PË. Ne kishim postblloqe, kishim detyra të ndryshme për çdo
2 fushë të jashtëligjshme, plaçkitje, akte dhune kur i zbulonim.
3 Atëherë në këto raste dislokonim policinë ushtarake nëse ishin
4 të disponueshëm, sepse nuk kanë qenë gjithmonë të
5 disponueshëm.

6 PY. Po ju vetë, besoni se kishit autoritetin të ndalonit
7 personat që dyshoheshin, personat që mund të ishin të dyshimtë
8 ose që mendohej se mund të kishin kryer vepra penale si
9 plaçkitje apo krime të tjera?

10 PË. Më së paku i kemi mbajtur të ndaluar dhe ia dorëzonim
11 policisë ushtarake, për shembull, ku kishte raste plaçkitjes
12 dhe që kishim raste të pastra plaçkitjeje.

13 PY. Pra, ju besonit se e kishit autoritetin t'i mbanit të
14 ndaluar këta persona, dhe më pas t'ua transferonit policisë
15 ushtarake.

16 PË. Po, kështu e kam kuptuar unë, sepse ishte vepër penale
17 dhe ne parandalonim veprat penale.

18 PY. Mbi ç'bazë ligjore i ndalonit ju këta persona ose të
19 paktën sipas jush cila ishte baza ligjore e asaj kohe për të
20 ndaluar personat?

21 PË. Ne i mbanim të ndaluar vetëm për një periudhë të shkurtër
22 kohore se përpiqeshim t'i dorëzonim ose më saktë t'i
23 transferonim sa më shpejt pasi të kishin kryer një krim. Dhe,
24 për shembull, vepra penale e plaçkitjes ishte një vepër që të
25 shtynte t'i mbaje të ndaluar personat të paktën për t'u marrë

1 identitetin.

2 PY. Dhe ju thatë që më pas ia transferonit policisë ushtarake
3 dhe kjo e fundit kishte administronte dhe burgun e ish-
4 ndërtesën e MUP-it. Pra, Pasi e morët ju nën kontroll
5 ndërtesën e MUP-it, kjo ndërtesë u kaluan në vartësinë e
6 policisë ushtarake ku ata krijuan ambiente ndalimi dhe atje
7 mbanin të ndaluar persona që i arrestonit ju apo njësitë e
8 tjera të KFOR-it gjerman.

9 PË. Detyra konkrete, tani sa i takon detyrës konkrete të
10 policisë ushtarake duhet të pyesni kreun e policisë ushtarake.
11 Ne thjesht i çonim atje. Kjo ishte pika ku çonim personat e
12 dyshuar që ne i ndalonim.

13 PY. Por ju mendonit që mund t'i mbanit të ndaluar vetëm mbi
14 bazën e dyshimit ose t'i arrestonit mbi bazën e dyshimit?

15 PË. Jo. I kemi kapur dhe me... konkretisht, në flagrancë,
16 pra. Për shembull, një person që ishte në një apartament e tha
17 që jetonte atje, unë i hapa dollapin, i tregova që në dollap
18 kishte vetëm veshje të një gruaje të moshuar, ishte e qartë që
19 ky person po plaçkiste atje.

20 PY. Policia ushtarake i mbante të ndaluar, por mbi ç'baza,
21 mbi ç'baza i mbante të ndaluar policia ushtarake, nëse e dini.
22 Baza ligjore, kush ishte për ndalimin e personave në burg?

23 PË. Nuk mund t'i përgjigjem kësaj. Për këtë duhet të flisni
24 me shefin e policisë ushtarake.

25 PY. Pra, ju nuk keni dijeni se cila ka qenë baza ligjore për

1 t'i ndaluar këta persona dhe për sa kohë mund t'i mbanit të
2 ndaluar?

3 PË. Për a kohë, nuk e di. Siç ju thashë është, ishte puna e
4 policisë ushtarake. Ka pasur juristë atje. Nuk e di, por këta
5 ishin personat përgjegjës për këtë detyrë.

6 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Kaq pyetje kisha.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Baiseu.

8 Z. BAISEU: [Përkthim] Ka mundësi të mos kemi pyetje, por
9 më jepni pak kohë që t'i rishikojmë edhe një herë pyetjet që
10 kishim gjatë pushimit të drekës dhe pas pushimit të drekës
11 mund t'ju them nëse do kemi pyetje apo jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Dëshmitar, tani do të bëjmë pushimin e drekës. Do të kthehemi
14 në sallën e gjyqit në orën 14.30. Faleminderit. Mund të
15 largoheni.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Seanca ndërpritet deri në orën 14.30.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.54

20 --- Seanca rifillon në orën 14.30

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 Sekretare, silleni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, z.
25 Dëshmitar. Mirë se vini.

1 Z. BAIESU: [Përkthim] Temat mbi të cilat kishim ndërmend
2 të bënim pyetje janë trajtuar dhe nuk kemi pyetje të tjera.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje
4 nga ana e Prokurorisë?

5 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Kemi një temë për të trajtuar.
6 Na jepni pak çaste, ju lutem.

7 Pyetje vijuese nga znj. Clanton:

8 ZNJ. CLANTON: [Përkthim
9 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Sot në transkript në faqen 72,
10 74, Avokati Mbrojtës iu paraqiti disa deklarata të bëra nga
11 Dirk Menzel lidhur me viktimën në ndërtesën e MUP-it. Pjesë e
12 dokumente ve që ju lexuan juve, në një pjesë të tyre thuhej se
13 Menzel ka thënë:

14 "... ky person ... ishte akoma gjallë, ai nuk ishte i
15 vdekur, ishte akoma i gjallë ... ndërkohë që ishte i lidhur
16 tek karrigia.

17 "... ndërkohë që po e lironim nga karrigia, mendoj që
18 vdiq gjatë këtij momenti ..."

19 Dëshmitar, ju kujtohet që kjo ju lexua më herët gjatë
20 seancës paraprake?

21 PË. Po, më kujtohet.

22 PY. Ju kujtohet që juve iu parashtru pyetja të konfirmonit se
23 ajo që ju kujtohet juve ishte ndryshe nga ajo që i kujtohej
24 Menzel? Pra, që juve ju kujtohej që e keni gjetur të vdekur,
25 ndërsa pjesa që ju lexua juve nga Menzel thotë që ishte

1 ndryshe, pra, ky mashkulli ishte gjallë, por që vdiq gjatë

2 kohës që po lirohej?

3 PË. Saktë. Unë e kam gjetur këtë person të vdekur.

4 PY. Dëshmitar, ju kujtohet se përpara pushimit qartësuat se

5 ju nuk e keni parë këtë person në të njëjtën kohë që e ka parë

6 Menzel, personin e vdekur?

7 PË. Saktë.

8 PY. Dëshmitar, Menzel ka bërë edhe disa komente shtesë, të

9 cilat do t'i lexoj tani nga dokumenti 072882-TR-ET Pjesa 2,

10 faqe 4 dhe po citoj:

11 "... mendoj që vdiq gjatë kohës që po e lironim, pra, në
12 këtë proces, kur e morëm ne atë ishte i vdekur".

13 Dhe pastaj në Pjesën 2, faqja 13 -- kërkoj ndjesë, nuk po

14 citoj këtu Menzel. Menzel i bëhet pyetje lidhur me një

15 fotografi të viktimës, e vdekur, e lidhur me pranga në karrige

16 dhe aty ai deklaroi kur pyetet:

17 "A ju kujtohet tani që patë fotografinë nëse e keni
18 ngritur atë, apo jo?"

19 Dhe ai përgjigjet:

20 "Ndoshta jo".

21 Dëshmitar, a ju kujtohet ju që ju është thënë që personi

22 që keni parë të vdekur i lidhur me pranga në karrige ishte

23 marrë nga aty, largu nga karrigia përpara që ta shihnit ju?

24 PË. Jo, nuk më kujtohet kjo. Unë e kam gjetur atë të ulur në
25 karrige.

1 PY. A ju kujtohet që ju është thënë që ky person ishte gjallë
2 kur forcat tuaj e kanë gjetur atë në ndërtesë?

3 PË. Jo. Mesa më kujtohet, më është thënë për një person të
4 vdekur.

5 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia, z.
6 Kryegjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Gjykatësi Barthe.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
10 Smith.

11 Pyetje nga Trupi Gjykses:

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Dëshmitar.

13 Trupi Gjykses ka disa pyetje shtesë për juve që ne mendojmë që
14 janë nevojshme për të kuptuar më mirë dëshminë tuaj dhe pyetje
15 ime e parë ka të bëjë me gjendjen e sigurisë në jug të Kosovës
16 në verë të 1999, në veçanti gjatë kohës ku ju keni qenë i
17 vendosur aty, i dislokuar aty në qershor të 1999.

18 Dhe së pari dua t'ju pyes çfarë roli luajti UÇK-ja lidhur
19 me këtë pikë, në qoftë se ka luajtur ndonjë rol? Për shembull,
20 a ka patur pika kontrolli të UÇK-së në rrugë?

21 PË. Në fillim menjëherë pasi ne shkua aty, kishte pika
22 kontrolli të UÇK-së. Por duke qenë se ne i konsideronim ato të
23 paligjshme i kemi ç'bërë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A i keni parë ju
25 personalisht këto pika kontrolli?

1 PË. Po, i kam parë dhe i kam ç'bërë, i kam larguar prej aty
2 vetë personalisht.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si i keni identifikuar ato
4 si të tilla, pra, që ishin pika kontrolli të UÇK-së?

5 PË. Aty kishte tek një kryqëzim rrugësh, kishte automjete dhe
6 personel dhe simbole të UÇK-së të pranishme aty.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni kontrolluar
8 letërnjoftimet e personave që qëndrojnë aty në këto pika
9 kontrolli?

10 PË. Në atë moment, në fillim fare, nuk ishte e qartë se ç
11 mund të bënim me këto persona sepse nuk kishim vend se ku t'i
12 mbanim, ku t'i mbledhim. Dhe thjesht i kemi ç'bërë, i kemi
13 larguar dhe u kemi thënë që është e paligjshme, nuk i kemi
14 lejuar ta bëjnë këtë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ushtarët apo njerëzit që
16 ishin në këto pika kontrolli a ua shpjeguan juve sepse i
17 kishin vendosur këto pika kontrolli?

18 PË. Nuk më kujtohet kjo. Por mendoj që nuk na kanë dhënë
19 shpjegim.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju thatë që personalisht
21 i keni ç'bërë këto, pra, i keni larguar këto pika kontrolli. A
22 i keni çarmatosur këta persona që ishin në pikat e kontrollit?

23 PË. Në fillim nuk i kemi çarmatosur sepse në atë kohë, në atë
24 moment nuk ishte e qartë a e kishin apo jo të drejtë që të
25 mbanin armë. Dhe më vonë nuk kishte më pika kontrolli të

1 paligjshme.

2 Më kujtohet një skenë. Ka qenë një grup i madh me të
3 cilët personat aty ishin të veshur me uniforma zvicerane,
4 ushtarë, pjesëtarë të UÇK-së. Të paktën kështu e quanin veten.
5 Dhe ata u përpoqën të ecnin me automjete nëpër Prizren dhe u
6 ndaluan nga pjesëtarët e UÇK-së në Prizren dhe ndodhi një
7 përballje mes tyre dy grupeve dhe ne ndërhyëm dhe pamë. Dhe
8 personat të cilët kalonin me uniforma, neve u kërkuan atyre që
9 të zhvishnin, të hiqnin, pra, uniformat dhe të vazhdonin me
10 rroba civile. Kjo është ajo që më kujtohet. Nuk ka patur armë
11 në këtë rast, nuk më kujtohet ndonjë skenë tjetër.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këta personat me uniformë të
13 ushtrisë zvicerane, a kishin shirita në krahë apo ndonjë
14 emblemë?

15 PË. Nuk më kujtohet me siguri. Sigurisht që duhet të ketë, ka
16 fotografi të kësaj ngjarjeje. Më kujtohet që janë dy apo tre
17 fotografi. Është e sigurtë që kishin bereta në kokë, por nuk e
18 di a kishin emblema të UÇK-së, nuk jam i sigurt. Ata donin të
19 mbanin beretat, po ne u kishim thënë atyre që duhet t'i hiqnin
20 rrobat ushtarake, përfshirë edhe beretat. Kjo më kujtohet.

21 Jam i sigurtë që kam një ose dy fotografi që kanë ngelur
22 nga kjo skenë. Dhe e di që një gazetar i *Der Spiegel* ishte aty
23 i pranishëm, fotografi ishte aty dhe duhet të ketë edhe
24 fotografi tjera, pra, të këtij incidenti, të kësaj ngjarjeje.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju, pra, ju si pjesëtar

1 i KFOR-it, u kishit thënë atyre që të hiqnin uniformat
2 zvicerane? A mund të na thoni arsyen pse u kërkuat atyre që të
3 hiqnin këto uniforma?
4 PË. Ndodhi një konfrontim, përballje verbale mes këtyre dy
5 grupeve shumë e tensionuar, pra, ata që ishin me uniforma
6 zvicerane dhe pjesëtarë të UÇK-së të pranishëm. Dhe për shkak
7 të kësaj përballje dhe për të ulur tensionet, nuk më kujtohet
8 nëse, nuk e di, nuk më kujtohet se ku donim të shkonim, po u
9 thashë atyre, "Hiqni uniformat dhe pastaj mund të kaloni,
10 përndryshe kjo do të shkaktojë probleme që nuk duam t'i kemi
11 këtu".

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të flasim
13 për ngjarjet në ish-ndërtesën e MUP-it në 18 qershor 1999.

14 A mund të përshkruani shkurtimisht gjendjen sa ushtarë të
15 UÇK-së apo persona që ju identifikuat si ushtarë të UÇK-së
16 ishin aty të pranishëm, përafërsisht më datën 18 qershor 1999,
17 pra, në ndërtesë e MUP-it?

18 PË. Në ndërtesë dhe rreth ndërtesën nuk mund të verifikoj sa
19 ishin në ndërtesë dhe jashtë ndërtesës. Po ne kemi gjetur
20 rreth 25 persona, ndër të cilët një grua.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kishte dhe civilë aty në
22 ndërtesë apo rreth ndërtesës?

23 PË. Nuk e di a kishte civilë në ndërtesë, por jashtë ishin
24 disa civilë. Dhe, për rrjedhojë, ne u përpoqëm që të krijojmë
25 një perimetër sigurie të jashtëm për t'u siguruar që të mos

1 përziheshin personat brenda këtij perimetri dhe personave që
2 hynin në këtë perimetër.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni se çfarë
4 po bënin civilët jashtë ndërtesë? A ishin thjesht kalimtarë
5 apo po bënin diçka në veçanti, diçka konkrete?

6 PË. Mund të flasim për dy grupe. Së pari jashtë perimetrit të
7 sigurisë ishin njerëz kureshtarë. Befasisht erdhën shumë
8 përfaqësues të shtypit. Dhe brenda perimetrit ishin personat
9 që ne nuk i lejuam të largoheshin nga ajo zonë përpara sesa të
10 zbulonim se çfarë kishte ndodhur. Morëm letërnjoftimet e tyre
11 dhe pastaj ua kthyen më vonë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Personat që ishin brenda siç
13 përshkruat ju, brenda perimetrit të sigurisë a ishin të gjithë
14 me uniformë apo kishte edhe me rroba civile?

15 PË. Më kujtohet që ishin pak, pesë ndoshta që nuk kishin vesh
16 rroba civile, të tjerët ishin me rroba të UÇK-së, që dukeshin
17 si uniforma dhe kjo ishte e dukshme, e qartë edhe në video.
18 Kishte edhe disa persona që ishin veshur me rroba civile.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbalin tonë, në
20 përgjigje ju thoni që "ishin disa pak, pesë ndoshta që nuk
21 kishin rroba civile, të tjerët ishin me të UÇK-së dhe ose të
22 paktën me rroba që ngjanin me uniformat". A është kështu?

23 PË. Nuk jam i sigurt, nuk e di a ka patur uniformë zyrtare në
24 atë kohë, të paktën kanë qenë lloje të ndryshme: Të zeza me
25 shirit në krah, pastaj kamuflazhi me shirit në krah dhe kapele

1 të ndryshme. Dhe kur fola për afërsisht për pesë persona. A
2 kanë qenë tani pesë nuk e di me saktësi.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, që të jemi të qartë
4 këta pesë persona, katër-pesë the ishin të veshur me rroba të
5 zeza apo si të zeza apo civile dhe pjesa tjetër e personave të
6 pranishëm me rroba kamuflazh?

7 PË. Rreth pesë vetë nuk kishin asnjë, nuk mbanin uniformë.
8 Ishin dy, një ose dy të tjerë të pranishëm. Unë thashë deri në
9 pesë. Nuk mund të jem i sigurtë për numrin. Por pak, disa, të
10 pranishëm aty ishin të veshur me rroba civile. Pastaj më vonë
11 kur personat e liruar u bashkuan këtyre, natyrisht që kishte
12 më shumë persona që ishin të veshur me rroba civile.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe po ashtu
14 përmendët personin apo një oficer që fliste frëngjisht me ju,
15 që foli frëngjisht me juve dhe e përshkruat, meshkuj të tjerë
16 apo persona, individë të tjerë që ishin aty afër pak më larg
17 dhe ju i keni identifikuar ata si pjesëtarë të UÇK-së, a është
18 kështu?

19 PË. Të paktën kështu u prezantuan ata përpara meje. Dhe,
20 kërkoi ndjesë, ne i kishim edhe letërnjoftimet e tyre dhe
21 mendoj, në qoftë se më kujtohet saktë, që kishin dhe
22 letërnjoftime të UÇK-së.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në intervistën e ZPS-së në
24 korrik 2019, keni thënë gjithashtu që keni parë një flamur që
25 ishte në ndërtesë, i vendosur mbi ndërtesë?

1 PË. Është e saktë. Dhe kjo është dhe arsyeja për të cilën u
2 afrova tek kjo ndërtesë. Ndërkohë gjatë kohë që po patrulloja
3 në qytet pash këtë dhe mendova që është flamur shqiptar dhe
4 kjo më bëri që të shoh këtë ndërtesë. Dhe pastaj pashë
5 automjetin e blinduar të kontingjentit gjerman dhe kështu u
6 zhvillua, vazhdoi më tej ngjarja.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani për
8 nevoja të procesverbalit, kjo ishte nga Pjesa 1 e intervistës
9 së ZPS-së, faqja 14.

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do të doja që
11 të kalonim në seancë private, ju lutem.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për pyetjet në vijim? Po?

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na kaloni në
15 seancë private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, shpresoj që të

25 jeni në gjendje të na ndihmoni të identifikojmë kohën e saktë

1 të ngjarjeve në ish-ndërtesën e MUP-it dhe vendin e dytë. Dy
2 ndërhyrjet në të cilat ju keni marrë pjesë kanë ndodhur më 18
3 dhe 19 qershor 1999, është kështu?

4 PË. Saktë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe serbët ishin larguar pak
6 ditë më parë nga ajo zonë, saktë?

7 PË. Saktë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mendoj që në deklaratën tuaj
9 në cilësinë e dëshmitarit përpara TPNJ-së në faqen U002-6105,
10 keni përmendur se disa pjesëtarë të UÇK-së jashtë ndërtesës së
11 MUP-it ju thanë juve se kishin qenë aty në ndërtesë për një
12 kohë të gjatë. Dhe ju gjithashtu thatë se ju kujtohet se kur
13 keni arritur në Prizren më 12 qershor, ndërtesa ishte akoma
14 nën ruajtjen e MUP-it dhe kjo gjë ishte e vërtetë, keni thënë
15 në deklaratën tuaj të TPNJ-së për datën 13 qershor.

16 Pra, ju keni konkluduar, përfunduar se UÇK-ja duhet ta
17 kishte marrë këtë ndërtesë menjëherë pas tërheqjes së MUP-it,
18 që është pas datës 13 qershor 1999, përpara ndërhyrjes tuaj në
19 ndërtesë më 18 qershor 1999, është e saktë?

20 PË. E saktë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini kur personat që ju
22 i keni identifikuar si pjesëtarë të UÇK-së kanë marrë nën
23 kontroll pikën e dytë për të cilën biseduam më herët, vendin e
24 dytë?

25 PË. Jo, nuk mund t'ju jap një datë të saktë, por duhet të

1 kenë qenë aty për një kohë më të gjatë sepse municionet dhe
2 armët që gjetëm aty nuk mund të ishin sjellë aty për pak orë.
3 Duheshin të paktën dy kamion për t'i transportuar aty.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju ka shpjeguar njeri se
5 përse të burgosurit në ndërtesën e MUP-it apo në vendin e dytë
6 ishin ndaluar? A ju ka thënë ndonjë njeri arsyen se pse ishin
7 ndaluar këta persona?

8 PË. Mesa më kujtohet, askush nuk ma ka shpjeguar arsyen aty
9 në vend.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka përmendur ndonjë njeri
11 termin "bashkëpunëtor" ose në njëjës ose në shumës, domethënë,
12 ka qenë "bashkëpunëtor" ose kanë qenë "bashkëpunëtorë".

13 PË. Nuk më kujtohet. Kanë kaluar shumë vite që prej atëherë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitar,
15 kemi biseduar gjatë ditës sot për ndërtesën e MUP-it dhe
16 vendin e dytë. Kemi folur gjëra e gjatë lidhur me këtë. A jeni
17 në dijeni të vendeve të tjera të ndalimit që pretendohen që të
18 jenë përdorur nga UÇK-ja në qershor të 1999 ose më herët për
19 arsye ndalimi?

20 PË. Unë e di që trupat që kanë qenë aty kanë liruar
21 gjithashtu edhe persona të mbajtur peng, po nuk është se di
22 hollësi të tjera.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në Pjesën 3 të transkriptit
24 të intervistës me ZPS-në, kemi përmendur edhe dy incidente të
25 tjera, përkatësisht vrasjen e dy serbëve të moshuar, një burri

1 dhe një gruaje, në vende të ndryshme, në dy anë të ndryshme të
2 rrugës në qytetin e vjetër të Prizreni. A ju kujtohet që t'ia
3 keni thënë këtë ZPS-së?

4 PË. Po, më kujtohet. Më kujtohen gjithashtu edhe situata sesi
5 janë gjetur këta dy persona.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo ka ndodhur në kohën kur
7 ju keni qenë në Kosovë, keni qenë të dislokuar në Kosovë, në
8 Prizren, apo jo?

9 PË. Po, unë kam qenë aty vetë. I kam parë me sytë e mi të dy
10 trupat e vdekur.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na jepni pak më
12 shumë hollësi lidhur me këto dy incidente?

13 PË. Z. Mezel që e përmendëm pak më herët, nuk më kujtohet se
14 çfarë rangu kishte, ai ishte duke patrulluar. Dhe së pari
15 gjeti një burrë në moshë në anë të një rruge dhe që ishte
16 goditur me anën e një kazme dhe pa gjithashtu edhe te disa
17 fotografi që ishin përtokë. Ishin fotografi të një ushtari
18 jugosllav që mund të kishin qenë të tij ose të djalit të tij.

19 Ndërkohë që nga ana e kundërt e rrugës gjetën një plakë
20 që ishte vrarë në të njëjtën mënyrë. Në qoftë se më kujtohet
21 siç duhet, ajo kishte qenë në dhomën e gjumit të saj dhe po
22 përpiquej që të fshihej pas derës të një prej rafteve në dhomën
23 e saj të gjumit.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet se kush i ka
25 kryer këto krime, kush i ka bërë këto vrasje?

1 PË. Z. Menzel ka mbërritur pak kohë pasi kishin ngjarë kjo.
2 Dhe dërgoi shumë njerëz në mënyrë të tillë që të shkonin dhe
3 të gjenin persona të dyshuar por nuk gjetëm askënd.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni të krimeve
5 të tjera përveç krimeve që sapo na përshkruat, Dëshmitar, pra,
6 a jeni në dijeni të krimeve të tjera të cilat i atribuoheshin
7 UÇK-së? Nuk e kam fjalën për dy incidentet se këtë e dëgjuam,
8 por po flasim për vrasjet, vrasjet në Prizren, për shembull,
9 vrasjen e këtij burrit apo të gruas. Apo ndalime, keqtrajtime?
10 Domethënë, a jeni në dijeni të ndonjë krimi tjetër qofshin ato
11 krime ndalimi, keqtrajtimi, vrasje e të tjera?

12 PË. Ne kemi gjetur një tjetër trup jashtë Prizrenit, dikush
13 që ishte goditur me thikë por trupi kishte disa ditë që
14 qëndronte aty. Dhe ishte e qartë, për shembull, kur hapëm
15 xhaketën ishte e mundur që të shikohej se ai ishte goditur me
16 thikë. Dhe një tjetër skenë është ajo me priftin që e
17 shpjegova pak më herët që ishte rrëmbyer dhe që ne nuk patëm
18 mundësi që ta ndiqnim dhe ta kapnim veturën me të cilën po
19 udhëtonin rrëmbyesit. Megjithatë nuk ju them dot se kujt grupi
20 i përkisnin të dyshuarit apo çfarë lloj historiku ose çfarë
21 lloj lidhjeje kishin personat e përfshirë në krime të tilla.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
23 të tjera për ju më.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
25 Mettraux.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
2 Smith.

3 Dhe mirëdita, Dëshmitar. Kam disa pyetje të tjera
4 plotësuese janë pyetje që kanë lidhje me pyetjet që u bënë pak
5 më herët lidhur me kaosin ose vakumin që keni vënë re në disa
6 prej vendeve që ku keni funksionuar kur keni qenë në Kosovë. A
7 ju kujtohen këto pyetje, Dëshmitar?

8 PË. Po, më kujtohen.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me aq sa dini ju dhe
10 mbështetur në konstatimet që keni nxjerrë si individ në
11 terren, çfarë masash apo çfarë hapash ka marrë UÇK-ja për t'u
12 përpjekur që të parandalojë ose të zvogëlojë kaosin me të
13 cilin jeni përballur?

14 PË. Unë nuk kam parë asnjë masë nga UÇK-ja për të parandaluar
15 ose për të zvogëluar kaosin, përveç pikave të paligjshme të
16 kontrollit që u përshkrova dhe më herët. Përveç këtyre, nuk
17 mund t'ju përshkruaj dhe nuk mund të më kujtohet asnjë masë të
18 marrë nga UÇK-ja.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ta kuptoj përgjigjen
20 tuaj sikur doni të thoni që, për shembull, policinë ushtarake
21 nuk e keni parë që të jetë përpjekur të marrë masa për
22 mbrojtjen e civilëve ose të pronave të civilëve, a është një
23 mënyrë interpretimi e përgjigjes tuaj kjo?

24 PË. Po. nuk e kam parë policinë ushtarake ta bëj këtë gjë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas përvojës tuaj, si

1 një oficer ushtarak me përvojë mbi 40 vjeçare, një strukturë e
2 arsyeshme ushtarake çfarë duhet të kishte bërë për të ulur ose
3 për të eliminuar rreziqet e lidhura me një mjedis të tillë kaq
4 të cenueshëm? Domethënë, pyetja ka të bëjë me faktin se çfarë
5 do të kishit bërë ju po të ishit në vendin e tyre, në qoftë se
6 do të donit që të parandalonit një dhunë të këtij dimensionit?
7 PË. Unë do kisha krijuar një strukturë të qartë. Për
8 shembull, në qoftë se shohim UÇK-në, unë do ta kisha ndarë
9 qytetin në sektorë të ndryshme, do kisha caktuar persona të
10 ndryshëm kontakti për marrëdhënien me KFOR-in në mënyrë të
11 tillë që të kishte komunikim të vazhdueshëm ndërmjet UÇK-së
12 dhe KFOR-it. Kjo do kishte qenë një prej masave që do kisha
13 marrë un. Megjithatë, përderisa kjo nuk ndodhi, ne ishim vetëm
14 ne dhe nuk kishim kontakte fare nga pala tjetër.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke marrë parasysh
16 përvojën tuaj si oficer gjerman, çfarë roli do kishte luajtur
17 policia ushtarake për t'u përpjekur që të ndalonte incidentet
18 të tjera? Ose me fjalë të tjera çfarë detyrash apo çfarë
19 përgjegjësish do i caktonin policisë ushtarake po të kishte
20 qenë roli juaj ky?

21 PË. Në Gjermani, kjo kufizohet shumë tek dislokimi.
22 Megjithatë, në përgjithësi, policia ushtarake luan funksionin
23 e policisë së përgjithshme, domethënë, të merrte detyrat dhe
24 përgjegjësitë kryesore të policisë së përgjithshme. Dhe kjo
25 nuk është bërë as nga policia ushtarake gjermane, me

1 përjashtim të hetimeve dhe protokolleve dhe nuk është bërë as
2 nga UÇK-ja.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E njëjta pyetje po ju
4 bëhet gjithashtu edhe sa i takon oficerëve drejtues ose
5 komandues. Domethënë, çfarë përgjegjësie do të kenë personat
6 drejtues, komandues në qoftë se do të gjendeshin në një
7 situatë të tillë të brishtë për të parandaluar kryerjen e
8 krimeve?

9 PË. Këta persona duhet që të respektonin disiplinën, të
10 siguroheshin që urdhrat që jepeshin të ndiqeshin dhe që të
11 parandalohej dhuna kundër personave të pafajshëm, në qoftë se
12 do të kishte konflikt të armatosur dhe të dhunshëm.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka ndodhur një gjë të
14 tillë, e keni parë ju një gjë të tillë të ndodhë me sytë tuaj
15 në zonën ku keni qenë ose në zonat përreth gjatë kohës kur
16 ishit në Prizren?

17 PË. E vetmja gjë që kam parë unë është si më poshtë: Disa
18 prej këtyre personave që unë i shikoja si komandant kishin
19 radiomarrëse-dhënëse që përdornin për të komunikuar, kështu që
20 duhet të ketë pasur një lloj kanali komunikimi. Domethënë, në
21 mos gabohem, kishin pajisje Motorola, radio marrëse-dhënëse
22 Motorola.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni ndonjë dijeni sa i
24 takon përpjekjeve të tyre sa i takon parandalimit të dhunës që
25 ju përshkruani që e keni parë me sytë tuaj?

1 PË. E vetmja gjë që më kujtohet mua është ndalimi i armëve
2 për të gjithë llojet e luftëtarëve. Në fillim, personat në
3 Prizren, merrnin ose atyre u jepej një shirit krahu. Dhe kjo
4 për neve në fakt ishte një shenjë që tregonte që ata personat
5 që e kishin këtë shiritin në krahë kishin të drejtë që të
6 mbanin armën, ndërsa personat e tjerë nuk kishin të drejtë,
7 pra, i mbanin armët në mënyrë të paligjshme.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
9 pyetje të tjera.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
11 Gaynor.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.
13 Dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me
14 instrumentet e torturës që ku thoni që keni parë në pjesën
15 përdhese të godinës së MUP-it në Prizren.

16 Referenca për palët e tjera është prova materiale P1177.1
17 në faqen 34 dhe 41.

18 Së pari, Dëshmitar, a ju kujtohet që na folët për
19 instrumentet e torturës?

20 PË. Po, më kujtohet.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na e përshkruani
22 se çfarë ishin konkretisht këto instrumente?

23 PË. Unë kam bërë një fotografi të tyre. Ishin disa armë të
24 cilat përdorshin për rrahje, domethënë, si instrumente për
25 rrahje dhe për të goditur. Disa të tjera ishin të

1 improvizuara. Megjithatë unë kam kaluar pak kohë aty. Kështu
2 që nuk kam pas kohë të mjaftueshme që të shikoja konkretisht
3 se cilat ishin këto instrumente. Unë personi që ishte
4 përgjegjës për situatën e përgjithshme. Kështu që thjesht sa i
5 kam hedhur një vështrim të përgjithshëm dhe pastaj vazhdova
6 për të qenë më i njohur me situatën jashtë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani, më vonë, në deklaratën
8 që i keni dhënë TPNJ-së në tetor të 2001, që është prova
9 materiale P1176, në faqen 4, ju thoni që keni parë "shenja të
10 personave të marrë peng dhe që tregonin që ata ishin
11 keqtrajtuar, përfshirë këtu edhe plagë të hapura. Dhe ishte e
12 qartë që ata ishin torturuar".

13 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, më kujtohet. Njerëzit dolën nga ndërtesa, disa prej
15 tyre që pikonin, rridhnin gjak, disa të tjerë që ecnin çalë-
16 çalë, i kam parë vetë me sytë e mi këto ngjarje.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Domethënë, kjo është arsyeja
18 që pse juve arritët në përfundimin që ata janë torturuar,
19 domethënë, fakti që keni parë njerëz duke ecur çalë-çalë dhe
20 njerëz të tjerë që kishin plagë të hapura dhe gjaku që u
21 rridhte?

22 PË. Po, është konkluzioni im, është përfundimin, është
23 përfundimi i vetëm i arsyeshëm tek i cili mund të mbërrihej
24 duke i parë këta njerëz që ishin të ndaluar dhe po largoheshin
25 nga godina.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni parë ndonjë lëndim
2 apo plagë mbi këto persona që ishin të qarta për ju që këto
3 lëndime ose këto plagë ishin shkaktuar nga instrumentet e
4 torturës që ju keni parë në godinën e MUP-it?
5 PË. Nuk ju jap dot një përgjigje të qartë lidhur me këtë. Nuk
6 e konfirmoj tërësisht dot faktin që këto kanë qenë
7 instrumentet e përdorura për plagët.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kalojmë në një temë
9 tjetër që sërish ka të bëjë me ish-godinën e MUP-it. Ju thoni
10 dhe këtu citoj që "është përdorur si pikë mbledhjeje për
11 dorëzimin e minave dhe të armëve", ky është fundi i citimit.
12 Është dhënë në faqen 34 të transkriptit të ditës së sotme. Dhe
13 thoni gjithashtu që keni shkuar atje disa herë.

14 A kam të drejtë ta kuptoj këtë që kjo godinë ka qenë një
15 pikë mbledhjeje për UÇK-në për dorëzimin e armëve të tyre,
16 është kështu, apo jo?

17 PË. Jo, duhet ta keni keqkuptuar besoj. Është vendi i
18 komandës së brigadës. Nuk ishte ish-ndërtesa e MUP-it. Por
19 ishte ish-ndërtesa e OSBE-së ose ndërtesa e Progresit siç
20 quhej ndryshe. Dhe kjo ishte pika e mbledhjes për mbledhjen e
21 të gjitha armëve që kemi gjetur. Disa prej këtyre armëve i
22 kemi gjetur në rrugë ose i kemi gjetur duke kërkuar nëpër
23 shtëpi ose thjesht na janë dorëzuar në mënyrë vullnetare. Pra,
24 me fjalë të tjera kjo ishte pika e mbledhjes së brigadës për
25 të gjitha llojet e ndryshme të armëve.

1 Në atë kohë, domethënë, për periudhën kur flasim, UÇK-ja
2 nuk po i dorëzonte akoma armët e veta.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po këto minat, për shembull,
4 në cilën anë ishin mbledhur, nga cila pjesë kishin ardhur?
5 PË. Më kujtohet që dy mina erdhën nga shkolla, për shembull.
6 Pata një bisedë të ashpër me ushtarët e mi për shkak të kësaj
7 sepse shkuan në shkollë dhe i morën minat. Kam një fotografi
8 me këto të dy mina antitank në një automjet. Dhe ato ishin
9 shumë të mëdhaja, ishin me diametër 25 centimetra. Njëra
10 kishte formë katrore. Dhe të dyja ishin prodhim jugosllav.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. A keni
12 mbikëqyrur, pra, në atë fazë kur keni qenë atje, a keni qenë
13 mbikëqyrës i armatimit të UÇK-së?

14 PË. Ne kemi sekuestruar armë nga UÇK-ja një herë. Kjo më
15 kujtohet. Po nuk më kujtohet vendi tamam ku ka qenë. Ajo çfarë
16 më kujtohet është që ose gjenerali Von Korff ose z. Bescht më
17 pyetën mua që t'i jepja armën mbrapsht njërit prej personave
18 të UÇK-së sepse ishte një armë e veçantë që kishte një dorezë
19 prej druri. Po unë nuk e respektova këtë urdhër që mu dha se e
20 kisha harruar se ku e kisha vënë atë armë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që
22 të paraqesë në ekran provën materiale P11889 dhe të mos e
23 transmetojë atë për publikun.

24 Dëshmitar, tani do shikojmë një raport që është një
25 raport i policisë ushtarake të KFOR-it gjerman që mban datën

1 23 qershor 1999. Do e shikojmë në këtë raport, e diskutuam dhe
2 më herët në fakt këtë gjë, por në raport thuhet që individ i
3 caktuar nuk ishte në listën e personave që lejoheshin që të
4 mbanin armë dhe municionin që ishte sekuestruar atij.

5 E në versionin në anglisht është rreshti i katërt drejt
6 fundit të faqes -- jo, në fakt është rreshti i tretë, jo katra
7 për në versionin gjermanisht. Ndoshta rreshti i pestë, i
8 gjashtë në gjermanisht. A e shikoni?

9 PË. Po, e kuptoj.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua ta kuptoj pak këtë
11 pjesën e listës së personave të autorizuar për të mbajtur
12 armë. A e keni parë ju vetë me sytë tuaj listën e personave që
13 ishin të autorizuar për të mbajtur armë?

14 PË. Nuk më kujtohet në qoftë se e kam parë listën apo jo.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në qoftë se kjo listë ka
16 qenë produkt i marrëveshjes midis Drinit dhe KFOR-it, a ju
17 kujtohet nëse ka qenë një prodhim ose një listë që ka ardhur
18 si rezultat i kësaj marrëveshjeje?

19 PË. Nuk e di. Por ajo çfarë mund të mendoj është që ne
20 përdornim radiot për të konstatuar në qoftë se një persona
21 ishte i autorizuar që të mbante armë apo jo. Megjithatë sa i
22 takon listës, si listë fizike ose një liste ku ishin të
23 shkruar personat nuk më kujtohet që ta kem parë një gjë të
24 tillë.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ushtarët e zakonshëm të

1 UÇK-së a ishin të lejuar që të mbanin armë apo në këtë fazë
2 ushtarët e zakonshëm të UÇK-së duhet që të ishin të çarmatosur
3 dhe t'i dorëzonin armët, si ka qenë situata?

4 PË. Ka pasur një grup që ishte i autorizuar që të mbante
5 armë. Kjo më kujtohet. Dhe pastaj erdhi një kohë kur askush
6 nuk lejohej që të mbante më armë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush kishte të drejtë të
8 mbante armë dhe kush nuk kishte të drejtë të mbante armë?

9 PË. Nuk mund t'ju them, nuk mund t'ju them se kush ishte i
10 autorizuar për të mbajtur armë apo jo. E vetmja gjë që di unë
11 është kjo, që kishte njerëz që ishin të autorizuar për të
12 mbajtur armë dhe kishte njerëz që nuk ishin të autorizuar që
13 të mbanin armë, megjithatë nuk ju them dot se kush e
14 autorizonte këtë gjë dhe nga kishte ardhur ky urdhër.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.
16 Nuk kam pyetje të tjera për juve.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një pyetje
18 ndoshta.

19 Gjatë kohës kur keni qenë në Prizren, Dëshmitar, sa herë
20 keni parë një person që kishte uniformë të UÇK-së që kishte
21 një shirit në krahë ose që kishte një kapele me shenjën e UÇK-
22 së, po që në fakt nuk kishte lidhje fare me UÇK-në?

23 PË. Në fillim kam parë shumë vetë me uniformë dhe uniformë të
24 pjesshme dhe ne e kishim të pamundur që ta identifikonim dhe
25 me kalimin e kohës numrat e këtyre personave u rritën.

1 Megjithatë nuk mund të thoja gjatë gjithë kohës në qoftë se
2 këta ishin persona të UÇK-së apo jo. Për aq kohë sa ata nuk
3 bënin diçka të dyshimtë, neve i toleronim ata pjesërisht.

4 Sa i takon kohës, nuk mund të them dot asgjë, nuk e di se
5 kur ka ndodhur diçka e tillë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kur kishit
7 dyshimet tuaja a ju kërkoni këtyre personave që t'ju jepnin
8 pasaportën ose kartën e identitetit?

9 PË. Po, kërkoni kartat e identitetit. Dhe, sigurisht, që i
10 bënim dhe pyetje të tjera të llojit, për shembull, çfarë bënin
11 aty, për shembull, në pikat e kontrollit të paligjshëm ose,
12 për shembull, kur gjenim persona në afërsi të shtëpive ku nuk
13 duhet të ishin, për shembull, tek zona e qytetit të vjetër, i
14 bënim pyetje pa diskutim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
16 Prokuroria ndonjë pyetje plotësuese mbështetur në pyetjet e
17 Gjykatësve?

18 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po Ekipet e
20 Mbrojtjes a kanë ndonjë pyetje?

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, kemi, të nderuar Gjykatës.

22 Pyetjet vijuese të palës tjetër nga znj.

23 Tavakoli:

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

25 PY. Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje lidhur me hapat që

1 kanë marrë UÇK-ja kur juve u dislokuat si KFOR për të mbrojtur
2 civilët. A ju kujtohet kjo pyetje që ju bë, Dëshmitar?

3 PË. Për cilin skenar e keni fjalën? Për çfarë lloj civilësh,
4 për çfarë po flisni?

5 PY. Unë po ju bëj pyetje lidhur me pyetjet e bëra nga
6 Gjykatësit. Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje. Gjykatësi
7 Mettraux është ky gjykatësi i ulur në mes. Gjykatësi Mettraux
8 ju bëri pyetje lidhur me hapat që patë që janë marrë nga UÇK-
9 ja për të mbrojtur civilët në kohën kur ishte dislokuar KFOR-
10 i. A ju kujtohet kjo pyetje, Dëshmitar? A ju kujtohen këto
11 pyetjet, Dëshmitar?

12 PË. Po, më kujtohen.

13 PY. Në rregull. Faleminderit. Gjithashtu ju bë pyetja në
14 qoftë se cilat ishin hapat që ju prisni që të bëhej nga një
15 strukturë normale ushtarake ose e arsyeshme, domethënë, në një
16 situatë të tillë çfarë ishin hapat që do të ndërmerre një
17 strukturë e arsyeshme ushtarake. A ju kujtohet kjo pyetje,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, më kujtohet.

20 PY. Kur KFOR-i ishte dislokuar kur ju u futët në Kosovë,
21 ligjërisht kush e kishte kompetencën për të ndaluar dhunën?

22 PË. Nuk jua them dot këtë gjë në hollësi, megjithatë ajo
23 çfarë di unë është që unë personalisht e kisha që të vendosja
24 urdhrin, sigurinë dhe të parandaloja krimet.

25 PY. Po, atëherë ishte detyra juaj që prej momentit kur u

1 futët dhe nuk ishte më detyra e UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Nuk mund t'ju them në qoftë se ishte detyra e UÇK-së më
3 ajo jo në këtë pikë.

4 PY. Unë ju them që aspekti ligjor ose ligjërisht nuk ishte më
5 detyrë e UÇK-së sepse në përputhje me Rezolutën e Këshillit të
6 Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, rezoluta në fjalë ju
7 autorizoi juve që të kishit të gjithë kompetencat të
8 transferuara nga NATO-ja. A pajtoheni me këtë, Dëshmitar?

9 PË. Po, pajtohem.

10 PY. Ju bënë disa pyetje dhe mënyra sesi është formuluar, janë
11 formuluar pyetjet ishin në kontekstin e përvojës tuaj si një
12 oficer ushtarak për 40 vite në ushtrinë gjermane. Po në
13 ushtrinë gjermane çfarë do të kishte ndodhur në qoftë se një
14 komandant do kishte dërguar trupat e veta në një zonë në të
15 cilën nuk lejohej që të futej nga eprorët e vetë? A lejohej
16 një gjë e tillë në ushtrinë, do ishte lejuar diçka e tillë në
17 ushtrinë gjermane, Dëshmitar?

18 PË. Jo, nuk do ishte lejuar, megjithatë do të varej nga
19 rrethanat në terren. Më kujtohet një incident, për shembull,
20 kur unë isha në zonën e dikujt tjetër megjithatë mua mu dha
21 urdhri që të shkoja atje, por nuk kishte pasur asnjë lloj
22 bashkërendimi. Ajo çfarë po përpiqem të them është që mund të
23 ketë detyra që mbivendosen mbi njëra-tjetrën dhe situata nga
24 më të ndërlikuarat sa i takon dislokimit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

1 Tavakoli, një sekondë. Domethënë, kemi një çështje që duam ta
2 trajtojmë.

3 Do i kërkoja Sekretares të na kalojë në seancë private.
4 Nuk ka të bëjë me ju, znj. Tavakoli, ka të bëjë me redaktimet
5 dhe nuk na ka ngelur shumë kohë, kështu që do i kërkoja
6 Sekretares të na kalojë në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 123

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

5 PY. Do ndryshoj pak temë pastaj do dal tek pika ime për
6 ushtrinë gjermane. Po sa i takon përgjegjësisë për rivendosjen
7 e rendit publik, ju thatë që përgjegjësia ishte e juaja. Dhe
8 në fakt, nëse ju do të mendonit, ju që ishte përgjegjësia e
9 UÇK-së nuk do i kishit çarmatosur postblloqet e tyre, apo jo?
10 PË. Nëse do të kishin pasur të drejtën për të pasur
11 postblloqe atëherë ne do t'i lejonim që t'i mbanin
12 postblloqet.

13 PY. Pra, nuk kishin të drejtë dhe ju i çarmatosët, saktë?

14 PË. Po.

15 PY. Tani të flasim për ushtrinë gjermane. Do ta formulojë në
16 këtë mënyrë: Në ushtrinë gjermane, nëse je në një fushëbetejë
17 dhe të thonë shprehimisht, të thotë shefi i shtabit, të mos i
18 fusësh forcat në një zonë të caktuar dhe ti sidoqoftë e bën,
19 çfarë do të kishte ndodhur ty? Do lejohej diçka e tillë?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po besoj se
21 këtë pyetje e ka bërë dikush dhe është marrë përgjigje.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po u përgjigje, po dha një
23 skenar alternativë dhe nuk është skenari që parashtrova unë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Le të përgjigjet.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Personalisht duhet të them, për
2 një urdhër që unë marr dhe nuk e respektoj duhet të kem një
3 arsye të fortë pse nuk e respektoj një urdhër të caktuar.
4 Përndryshe do të duhet t'i jap eprorit tim, madje edhe në
5 gjykatë do jepja llogari për këtë. Por nëse unë besoj se kam
6 arsye të forta e bindëse për të mos e respektuar një urdhër,
7 atëherë mund të ndodhë diçka e tillë.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

9 PY. Do të doja që të shihnim një bllok shënimesh të KFOR-it
10 apo regjistrin e KFOR-it, ditarin e luftës së KFOR-it.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mban numrin SITF002205092 deri
12 në SITF00225084, ndërsa në gjermanisht është me numër
13 SITF00224386 në 00225261.

14 PY. Këtu janë disa aspekte me atë që ka bërë apo nuk ka bërë
15 UÇK-ja që ka bërë KFOR-i gjerman kur ishte në terren, pyetjet
16 konkrete lidhur me këtë ua bëri gjykatësi Mettraux më
17 konkretisht ju pyeti çfarë bëri UÇK-ja për të ndaluar dhunën.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 291, në
19 materialin SITF00225139. Shkojmë tek referenca me numër
20 181125Bjun, më duket se kjo është. Faleminderit.

21 PY. Është diku në fund të faqes, pra, kolegët tuaj kanë bërë
22 këtë shënim në ditar:

23 "Përmbledhje nga KFOR

24 "Gjatë bisedimeve me figurat e vjetra myslimane dhe
25 komandantët e UÇK-së në Dragash, të dyja palët u pajtuan në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 126

1 mënyrë solemne që nuk do të merrnin hak kundër njëri-tjetrit”.

2 Jeni në dijeni të kësaj?

3 PË. Jo, nuk kam dijeni për këtë incident.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen SITF00225125.

5 Referenca e parë që dua të shohim këtu është 1710408Bjun.

6 PY. Dhe thotë:

7 “Raport OPS Info:” lexon.

8 “Zona e SMAC DM7783 dhe NOVAKE DM 8083 kryesisht të
9 kontrolluara nga serbët ndonëse oficeri i UÇK-së Tscholaku u
10 përpoq të binte popullatën serbe të qëndronte - më falni - e
11 braktisur nga serbët”.

12 Keni dijeni për këtë?

13 PË. Jo.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë më poshtë, është
15 shënimi përkatës që mban numrin 17100Bjun. Më falni, ua thashë
16 gabim. Bëhet fjalë për referencën me numër 17100. Ju kërkoj
17 faqen se nuk po gjej faqen e duhur. Këtu.

18 PY. “Raport nga OPS Info”

19 “Për refugjatët të cilët në mënyrë të përsëritur janë
20 informuar se KFOR-i do që popullata të qëndrojë dhe se UÇK-ja
21 ka sinjalizuar dakordësinë e vet në mënyrë që ata të
22 qëndrojnë”.

23 Dëshmitar, keni dijeni për këtë?

24 PË. Unë tani po e shoh raportin në gjermanisht, po pashë dhe
25 raportin pak më përpara. Do ju thoja ta verifikonit dhe një

1 herë këtë paragrafin që lexuat.

2 PY. Kjo është pjesë e provave në fakt.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shohim dhe në shënim tjetër që
4 është në materialin SITF00225139. 191500Bjun. Faleminderit.

5 PY. Këtu thuhet:

6 "Dy luftëtarët e UÇK-së i raportojnë brigadës operative,
7 pra, OPS Brig dhe ofrojnë shërbimet e tyre për heqjen e
8 minave".

9 Keni dijeni për këtë?

10 PË. Jo, nuk kam pasur dijeni për këtë.

11 PY. Pra, ka pasur zhvillime në zonën tuaj për të cilat ju nuk
12 keni pasur dijeni. Ky është përfundimi që del nga e gjithë
13 kjo, apo jo?

14 PË. Për këta dy luftëtarët e UÇK-së që kanë kontaktuar
15 brigadën e dislokimit, nuk di ç'të them. Se unë kam qenë në
16 një qytet tjetër në një njësit tjetër, këtu bëhet fjalë për
17 një vend tjetër.

18 PY. Po unë nuk po ju qorto. Thjesht mund t'ju them që s'mund
19 të kontrolloni çdo gjë që ndodhte.

20 PË. Po.

21 PY. Pra, ka pasur raste që ndonëse se kishin kompetencat
22 ligjore nga ana e UÇK-së ka pasur persona që janë përpjekur të
23 ofrojnë ndihmë, të qetësojnë situatën, të ofrojnë shërbimet e
24 tyre. Të paktën kjo duket nga ky ditar, apo jo?

25 PË. A donin të tregoni se ishin bashkëpunues, unë s'e di.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dietrich Jensch (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 128

1 Kanë ofruar të marrin pjesë, por mbi ç'baza nuk di të them.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të kërkoj të pranohen
3 tek provat gjyqësore këto tri faqet, SITF00225139,
4 SITF00225125 dhe SITF00225131.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
6 kundërshtime nga ana e Prokurorisë?

7 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
9 numër SITF00225125, materiali SITF00225131 dhe SITF00225139
10 pranohen dhe marrin numrin e provës materiale.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqet e sapo cituara
12 marrin numrin e provës materiale 1D1131. Por, do ju lutesha,
13 të nderuar Gjykatës, gjatë pushimit Avokatja të na sqarojë
14 edhe një herë numrin e faqeve se nuk ka pasur përputhje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
16 O'Reilly, a keni ju pyetje?

17 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, kam disa pyetje dhe janë
18 disa faqe të një dokumenti që përdora më herët që do të doja
19 që të pranoheshin tek provat gjyqësore.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
21 çaktivizuar]

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në rregull.

23 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

24 O'Reilly:

25 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

1 PY. Do qëndrojmë tek i njëjti dokument, tek e njëjta temë dhe
2 doja të shihnim një shihnim një dokument tjetër që ka lidhjen
3 me bastisjen e 18 qershorit.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në anglisht është në faqen 41
5 dhe në gjermanisht është në faqen 301.

6 PY. Do t'ju lexoj pjesën në anglisht. Është titulli
7 "Diskutimi me komandantin e UÇK-së Drini":

8 "Me OPS HQ Brig", brigadën operative, pra.

9 "- Janë bërë diskutime me komandant Drinin të UÇK-së për
10 çarmatosjen e UÇK-së në ndërtesën e MUP-it.

11 "- Ofertë nga komandant Drini për të mbështetur brigadën
12 nëse do të ketë probleme me plaçkitësit dhe hajdutët në zonën
13 e Prizrenit.

14 "- Propozim për krijimin e një force policore të
15 përbashkët."

16 Dëshmitar, duke qenë se ju keni qenë i përfshirë të
17 paktën në këtë operacion, a ju kujtohet kjo?

18 PË. Po, kjo më kujtohet, por ka pasur dy ngjarje që
19 mbivendoseshin me njëra-tjetrën. Pikë së pari, është diskutimi
20 me OPZ me oficerin De Kant dhe ka qenë dhe situata atje në
21 terren.

22 PY. Nuk besoj se e kuptova përgjigjen. Çfarë deshët të
23 thonit? A mund të na e sqaroni pak më mirë përgjigjen tuaj?

24 PË. Ju thatë apo më saktë hamendësuar që bëhet fjalë vetëm
25 për atë që ka ndodhur në ndërtesën e MUP-it. A e kam kuptuar

1 unë siç duhet?

2 PY. Sipas raportit ka pasur diskutime dhe kjo është fjala
3 kyçe, me komandant Drinin për çarmatosjen e UÇK-së në
4 ndërtesën e MUP-it dhe Drini është ofruar ta mbështesë
5 brigadën dhe s'do të kishte probleme me hajdutët dhe me
6 plaçkitësit. A ju kujtohet kjo?

7 PË. Nuk ka ndodhur në praninë time, por ka ndodhur me
8 brigadën e dislokimit, se përmendet këtu termi OPZ.

9 PY. Faleminderit për sqarimin.

10 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja
11 që të pranohej kjo faqe dhe dy faqet e një dokumenti që
12 përdora më herët, mund t'ju jap dhe numrat, bëhet fjalë për
13 faqen 60 në anglisht dhe 320 në gjermanisht, si dhe faqja 88 e
14 anglishtes dhe faqja 348 e gjermanishtes.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

16 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është e njëjta, nuk mund t'ju
17 jap konkretisht ERN për këto faqe, po mund t'ia jap Sekretares
18 pasi të përfundojmë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Mund ta bëjmë më vonë këtë.

21 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

22 PY. Kam dhe një temë tjetër që dua ta sqaroj me ju,

23 Dëshmitar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

25 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
2 kundërshtim për pranimin e këtyre provave materiale? Në thelb
3 janë pjesë e një dokumenti që është pranuar tashmë.

4 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nëse faqet që janë përdorur më
5 herët dhe jam e bindur që janë këto faqe, nuk kemi
6 kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Do t'i pranojmë. Nëse ka ndonjë pyetje lidhur me identifikimin
9 apo me numrat e referencës, do ta trajtoni këtë me Sekretaren
10 e Gjykatës.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]
12 PY. Dëshmitar, në faqen 90 të transkriptit të ditës së sotme,
13 Gjykatësi Barthe ju pyeti lidhur me shqiptarët që vishnin
14 uniforma, qofshin këto gjermane, zvicerane të UÇK-së. Dhe ju
15 thatë:

16 "... sa i takon plaçkitjes, ajo që më kujtohet mua është
17 që mbanin në fakt uniforma të UÇK-së".

18 Unë dua të sqaroj diçka me ju, Dëshmitar, kur thatë ata
19 persona mbanin uniforma të UÇK-së, e keni fjalën për persona
20 që ju kishit arsye të besonit që, në fakt, në të vërtetë nuk
21 ishin anëtarë të UÇK-së, pra, këta që plaçkitnin në të vërtetë
22 nuk ishin anëtarë të UÇK-së po thjesht mbanin uniforma të UÇK-
23 së, kështu?

24 PË. E saktë.

25 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

1 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

3 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
5 dëshmia juaj përfundoi. Faleminderit që erdhët, faleminderit
6 që dhatë dëshminë tuaj. Ju urojmë që të jeni sa më mirë. Rrugë
7 të mbarë.

8 Mund të largoheni nga salla e gjyqit.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit edhe ju.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria, e
12 ka gati dëshmitarin e radhës?

13 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po. Po na nevojitet pak pushim
14 për këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
16 çaktivizuar] ... në rregull. Le të fillojmë me dëshmitarin e
17 radhës dhe të bëjmë sa të mundemi.

18 Bëjmë dhjetë minuta pushim. Po mos u largoni.

19 --- Seanca ndërpritet në orën 15.48

20 --- Seanca rifillon në orën 15.59

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 sillni dëshmitarin në sallë, znj. Asistente.

23 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, z.
25 Dëshmitar. Tani do të lexoj tekstin e betimit solemn që mbas

1 të cilit ju kërkohet të thoni të vërtetën. Do ta lexoj pjesë-
2 pjesë, do t'u përkthehet dhe ju do ta përsërisni pas meje.

3 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime.

4 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe

6 përgjegjësinë time ligjore.

7 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Deklaroj

9 solemnisht se do të them të vërtetën

10 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Krejt të

12 vërtetën dhe vetëm të vërtetën.

13 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe nuk do të

15 mbaj të fshehtë asgjë për të cilën ka dijeni.

16 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

18 uleni.

19 Dëshmitar, dëgjuat betimin solemn. E pranoni këtë betim

20 solemn?

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

22 DËSHMITARI: JOHAN FRITSCH

23 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të

25 fillojmë me dëshminë tuaj që pritet të zgjasë -- besoj që do

1 të jetë një ditë, një ditë e plotë.

2 Siç e dini Prokuroria do të jetë e para që do t'ju bëjë
3 pyetje. Pastaj Mbrojtja ka të drejtën të bëjë pyetje.

4 Gjithashtu anëtarët e Trupit Gjykues mund të bëjnë pyetje edhe
5 ata.

6 Prokuroria sipas -- ka kërkuar sipas vlerësimit të tyre -
7 - znj. Prokurore sa kohë mendoni që keni nevojë?

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Rreth 45 minuta.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Atëherë do të jetë rreth 45 minuta. Pas kësaj Mbrojtja do t'ju
11 bëjë pyetje. Duke patur parasysh që të përdorin kohën në
12 mënyrë sa më efikase dhe efiçente. Gjithashtu edhe anëtarët e
13 Trupit Gjykues mund të bëjnë pyetje në qoftë se kushtet për
14 një gjë të tillë plotësohen.

15 Përpiquni t'i përgjigjeni pyetjeve në mënyrë të qartë dhe
16 të shkurtër. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen kërkonit që të
17 përsëritet pyetja. Gjithashtu tregoni me saktësisht bazat mbi
18 të cilat ju jepni përgjigjet apo njohurinë për faktet dhe
19 rrethanat mbi të cilat ju bëhen pyetje.

20 Në rast se ju bëhet pyetje nga ZPS-ja që të vërtetoni
21 disa korigjime të bëra, konfirmoni në procesverbal sipas
22 deklaratës me shkrim, siç janë korigjuar -- sipas listës së
23 korigjimeve dhe të pranoni pra, të konfirmoni që këto
24 pasqyrojnë deklaratën tuja.

25 Gjithashtu, flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë

1 sekonda përpara që të jepni përgjigje me qëllim që përkthyesit
2 të kenë kohë të përkthejnë.

3 Gjatë ditës që vjen, ju do të jepni dëshmi në këtë
4 Gjykatë. Nuk ju lejohet të diskuto -- të bisedoni përmbajtjen e
5 dëshmisë tuaj me askënd jashtë kësaj sale. Në qoftë se dikush
6 ju bën pyetje jashtë Gjykatës lidhur me dëshminë tuaj, na
7 tregoni.

8 Në qoftë se ju kërkohet që të ndaloni ndërsa jeni duke
9 folur ju lutem binduni dhe do ta -- në qoftë se më shikoni që
10 ngrej dorën. Këto do të thotë që kam ndonjë udhëzim për t'ju
11 dhënë.

12 Gjithashtu, në qoftë se keni nevojë për pushime, për
13 pushim na tregoni dhe ne do t'ju japim pushim.

14 A keni ndonjë pyetje lidhur me rregullat që ju thashë?

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Atëherë do të fillojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë
18 që janë të ulur në të majtën tuaj.

19 Znj. Prokurore mund të vazhdoni.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

21 Pyetje nga znj. Iodice:

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, zotëri. Jemi takuar më parë. Quhem Jega -- Vega
24 Iodice, sot do t'ju bëj disa pyetjes në emër të Prokurorisë --
25 Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Siç ju kam sqaruar në

1 takimin e fundit që kemi patur bashkë, në vend që t'ju bëj
2 pyetje për çdo pikë relevante apo të rëndësishme për të cilat
3 ju mund të keni informacion, është e mundur që të pranohen
4 disa nga deklaratat tuaja të më përparshme që kanë, përmban
5 deklaratat -- informacione të tilla. Do të pranohen në prova.

6 Përpara se të kalojmë tek këto pika mund të na jepni
7 emrin, ju lutem.

8 PË. Quhen Johan Rudolf Fritsch.

9 PY. Datëlindja juaj?

10 PË. Me 3 nëntor 1951.

11 PY. Vendlindja?

12 PË. Mynih.

13 PY. Kombësia?

14 PË. Gjerman.

15 PY. Cili është profesioni juaj?

16 PË. Jam pensionist ushtarak profesionist.

17 PY. Cila ka qenë grada e fundit që mbanit në ushtri?

18 PË. Kam -- rreshter.

19 PY. Tani do t'ju tregoj disa dokumente, në qoftë se

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që të shfaqë
21 në ekran dokumentin me ERN 071136 Pjesa 1 e Rishikuar, RED1 në
22 anglisht dhe origjinalin 071136-TR-ET, Pjesa 1 e Rishikuar,
23 RED.

24 PY. Zotëri, a ju kujtohet që jeni intervistuar nga ZPS-ja në
25 2019?

1 PË. Po.

2 PY. A ju kujtohet që e keni lexuar këtë deklaratë në gjuhën
3 tuaj në prill kur jemi takuar?

4 PË. Po.

5 PY. A ju kujtohet që ju është dhënë mundësia që të jepni
6 sqarime lidhur me deklaratën tuaj?

7 PË. Po.

8 PY. A ju kujtohet që këto sqarime janë shënuar në një shënim
9 e cila u është lexuar edhe juve?

10 PË. Po.

11 PY. Konfirmoni që ajo që u është lexuar juve nga ai shënim
12 pasqyron ndryshimet që keni bërë në tërësi dhe në mënyrë të
13 saktë?

14 PË. Po.

15 PY. Duke përfshirë të gjitha korigjimet, sqarimet që keni
16 dhënë, informacionet në deklaratën tuaj janë të sakta dhe të
17 vërteta për atë që keni thënë dhe besoni?

18 PË. Po.

19 PY. E njëjta -- në qoftë se ju bën të njëjtat pyetje sot për
20 lidhur -- për të njëjtat ngjarje, do të jepnit të njëjtat
21 përgjigje?

22 PË. Po.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Duke qenë se kemi përmbushur
24 kushtet nga rregulla 154 dhe në përputhje me paragrafin (A),
25 (B) të transkriptit që është 071136-TR-ET Pjesa 1 Rishikuar 1

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Johan Fritsch (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 138

1 RED, Pjesa 2, e Rishikuar 1, Pjesa 3, e Rishikuar 1 RED, dhe
2 Pjesa 4 dhe 5 Rishikuar 1 dorëzojmë -- paraqesim si prova
3 materiale bashke me përkthimin shqip dhe versionin origjinal
4 në gjermanisht.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
6 kundërshtim?

7 PËRKTHYESI: Nuk ka kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ERN 071136-
9 TR-ET Pjesa e Rishikuar 1 RED1, pjesët nga 1 deri në 5 në
10 shqip pranohen dhe do t'ju jepet atyre një numër si provë
11 materiale.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 për dokumentin ERN 071136-TR Pjesa 1 Rishikuar RED bashkë me
14 versionet shqip dhe anglisht, këto marrin numrin P1191.1 si
15 provë materiale.

16 Pjesa 2 me të njëjtën numër ERN dhe versionet në
17 gjermanisht, anglisht, shqip ju jepet numri i provës materiale
18 P1192 [Sipas përkthimit].

19 Pjesa 3, gjermanisht, anglisht, shqip i jepet numri
20 P01191.3.

21 Pjesa 4, anglisht, shqip, gjermanisht i jepet numri i
22 provës materiale P1191.4 [Sipas përkthimit]

23 Dhe Pjesa 5, anglisht, shqip, gjermanisht numri i provës
24 materiale P1191.5.

25 Dhe në qoftë se mund të konfirmojmë klasifikimin?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Publik.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
3 ka nevojë të riklasifikohet do të jetë publike.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshirojmë gjithashtu të
5 parashtrojmë Shënim Përgatitor numër 1 dhe i cili ka ERN
6 120506 deri në 120059 -- 120509.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
8 kundërshtim për shënimin përgatitor?

9 PËRKTHYESI: Nuk ka kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ERN 120506
11 deri në 120509 pranohet.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr numrin e
13 provës materiale P1192. Dhe edhe këtu do të doja të dija
14 klasifikimin.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Edhe kjo mund të jetë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
17 Riklasifikohet si publike.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në qoftë se vazhdojmë me provat
19 materiale të lidhura me të kemi krijuar një pjesë të nxjerrur
20 nga videoja 054010 deri në 02, 00:32:26 deri në 00:22:56
21 [Sipas përkthimit], me transkriptin që përputhet me këtë si
22 pjesë e nxjerrë. Do të donim që të dorëzojmë edhe këtë si
23 provë. Edhe kjo është publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është vetëm
25 kjo pjesë prove që e lidhur me këtë?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, sepse
2 pjesa tjetër është pranuar në tërësi si nën numrin P00501, dhe
3 do të trajtojmë çështjen e ditarit në mënyrë të ndarë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
5 kundërshtim për provën materiale të propozuar?

6 PËRKTHYESI: Nuk ka.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk ka.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
9 e provës materiale P01193 dhe do të klasifikohet si publike.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të doja të lexoja
11 përmbledhjen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari 03881 ishte dislokuar
14 në Kosovë nga 14 qershor deri me 3 gusht 1999 si zyrtar për
15 shtyp brenda -- me kontingjentin e KFOR-it. Pjesë e detyrave
16 të tij ishte shoqërimi i gazetarëve, dokumentimi dhe raportimi
17 dhe bërja e fotografive në vendngjarje sipas kërkesës së
18 policisë ushtarake të KFOR-it.

19 Dëshmitari 03881 ishte i pranishëm me 18 qershor 1999 kur
20 KFOR-i ndërhyri ish-ndërtesën e MUP-it në Prizren e zënë në
21 atë kohë nga ushtarët e UÇK-së dhe liroi disa të ndaluar të
22 lënduar.

23 Dëshmitari 03881 pa trupin e pajetë të një ndaluar dhe
24 konfirmoi se KOFR-i trajtoi lëndime të të ndaluarve. Ai bëri
25 fotografi të viktimave, lëndimeve të tyre dhe materiale të

1 sekuestruara nga KFOR-i të marra prej ushtarëve të UÇK-së.

2 03881 gjithashtu ishte i pranishëm dëshmitar dhe
3 dokumentoi dhunë ndaj pakicave serbe dhe rome.

4 Dëshmitar 03881 mbajti një ditar të shkruar me dorë me
5 fotografitë që kishte marrë -- që kishte bërë.

6 PY. Tani kam disa pyetje shtesë për ju, z. Ing [Sipas
7 përkthimit]

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që të shfaqë
9 në ekran dokumentin me ERN 071142 deri në 071313 në anglisht
10 dhe në versionin origjinal 071139-071313. Dhe të shkojmë në
11 faqen 071142 në të dy gjuhët. Dhe kjo nuk duhet të shfaqet për
12 publikun. Faleminderit.

13 PY. Zotëri, e njihni këtë dokument?

14 PË. Po. Ky është ditari im.

15 PY. E keni shkruar ju?

16 PË. Po, çdo ditë në mbrëmje.

17 PY. Çdo ditë në mbrëmje kur saktësisht?

18 PË. Në 1999, duke filluar nga momenti kur u diskolova në
19 Maqedoni përmes pastaj hyrja në Kosovë deri në kthimin tim në
20 gusht 1999.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të kalojmë tani në faqen
23 me ERN 071180 në anglisht dhe gjermanisht. Kjo është faqja 42
24 në gjermanisht dhe 39 në anglisht. Dhe ky dokument nuk duhet
25 të shfaqet për publikun.

1 PY. Zotëri, i njihni këto shënime?

2 PË. Po.

3 PY. Ju i keni shkruar edhe këtë pjesë?

4 PË. Po, e kam shkruar këtë në mbrëmje ose gjatë natës mes
5 datës 18-19 qershor 1999.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani kalojmë te pjesa e dytë e
8 faqes. Në anglisht është paragrafi -- që është në anglisht
9 paragrafi i fundit. Në gjermanisht është pak më poshtë. Fillon
10 "në pasdite".

11 PY. A mund ta lexoni këtë pjesë e cila fillon me fjalët "Në
12 pasdite, gjatë pasdites ..."

13 PË. [Nuk ka përkthim]

14 PY. Mund ta lexoni pa zë, nuk është e nevojshme ta lexoni me
15 zë të lartë. Faleminderit.

16 A ju kujtohet koj ngjarje?

17 PË. Më kujtohet shumë mirë kjo ditë.

18 PY. A përputhet data që është në ditar me datën e ngjarjes së
19 përshkruar aty?

20 PË. Po, më kujtohet kjo saktësi sepse është dita e martesës
21 time.

22 PY. Pyetja është: Kjo e njëjta ngjarje të cilën ke -- për të
23 cilën ke biseduar në intervistën tënde me ZPS-në që ka të bëjë
24 me ndërhyrjen e KFOR-it në ndërtesën e MUP-it?

25 PË. Po, më kujtohet.

1 PY. A është përshkruar saktë këtu në këtë pjesë?

2 PË. Është e përshkruar në mënyrë të shkurtër por të saktë.

3 PY. A e keni rishikuar dhe konsultuar këtë pjesë të ditarit
4 tuaj gjatë intervistës me ZPS-në?

5 PË. Po.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen vijuese në
7 të dy gjuhët.

8 PY. Kush i ka bërë këto fotografi, zotëri, këtë fotografi?

9 PË. Unë e kam bërë.

10 PY. A mund ta përshkruani çfarë shihet aty?

11 PË. Po. Këta janë ushtarë të mbrojtjes ajrore nga Kompania e
12 Mbrojtjes Ajrore, kompani që ishte përfshirë në çlirimin e
13 këtij burgu, dhe në fakt e çliruan këtë burg.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen vijuese
15 në të dy gjuhët.

16 PY. A është ky vazhdimi i pjesës së shkruar më parë në
17 ditarin tuaj?

18 PË. Po.

19 PY. Ju lutem përqendrohuni tek dy rreshtat e parë ku ju
20 përmendni etninë e viktimave dhe pastaj përmendni fjalën
21 "bashkë -- kolaboratorët, bashkëpunëtorët", për çfarë e keni
22 fjalën këtu?

23 PË. Këtu po ju -- i jam referuar bisedave kemi bërë me
24 personat e liruar.

25 PË. Ky është momenti kur keni dëgjuar që këta persona ishin

1 bashkëpunëtorë?

2 PË. Tani ne nuk mund ta verifikonim këtë. Kjo është diçka që
3 na është thënë nga njerëzit e UÇK-së.

4 PY. Në rregull. Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
6 faqen vijuese në të dy gjuhët.

7 PY. Zotëri, kush i ka bërë këto fotografi?

8 PË. Këto fotografi që i kam bërë unë sipas kërkesës në emër
9 të policisë ushtarake gjatë dhe pas liritimit.

10 PY. Çfarë e keni fjalën kur thoni "lirim"?

11 PË. Ne hymë në ish-burgun e MUP-it, liruan të burgosurit dhe
12 gjithashtu gjetëm personin e vdekur në katin e parë.

13 Pjesëtarët e UÇK-së të pranishëm aty u çarmatosën dhe personat
14 e lënduar, siç mund t'i shihni këtu në këtë fotografi u
15 trajtuan nga ekipi jonë mjekësor.

16 PY. Faleminderit. Dhe që të jemi plotësisht të qartë a mund
17 ta përshkruash -- a mund të përshkruani fotografitë që janë
18 përballë jush që i keni bërë ju?

19 PË. Mund të shihni këtu disa prej 12 deri në 12 meshkujve, me
20 sa më kujtohet. Dhe unë kam dokumentuar lëndimet e tyre duke
21 përdorur kamerën time. Ata kishin mavijosje, prerje, gjëra
22 tregonin keqtrajtim apo torturë.

23 PY. Dhe kemi një shënim mes dy fotografive. E keni shkruar ju
24 vetë këtë?

25 PË. Po. E kam shkruar.

1 PY. Ku jeni bazuar ju që të shkruani këtë gjë, nga e keni
2 patur këtë njohuri?

3 PË. Burrat që ne liruan na thanë këtë gjë.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani në mund të kalojmë në faqen
6 në vijim, në faqen vijuese në të dy gjuhët.

7 PY. Kush i ka bërë këto fotografi?

8 PË. Unë i kam bërë në emër të policisë ushtarake.

9 PY. Kur i keni bërë?

10 PË. Pasditen e datës 18 qershor 1999.

11 PY. A ishte kjo pjesë e ndërhyrjes në ndërtesën e MUP-t?

12 PË. Po. Gjatë kësaj ndërhyrje ne gjetëm këtë personin e
13 vdekur.

14 PY. Dhe shënimin në mes dy fotografive, për çfarë e kishit
15 fjalën, çfarë donit të thonit me këtë?

16 PË. Një burrë, një mashkull i vdekur u ekzaminuar nga njëri
17 prej oficerëve tanë mjekësorë dhe tha që ne kishim arritur
18 atyre rreth një orë vonë, me vonesë. Pra, ky burrë kishte
19 vdekur me gjasë një orë përpara ndërhyrjes, arritjes tonë aty.

20 PË. Faleminderit.

21 PY. Këtë mashkull që shihet këtu e keni gjetur në këtë
22 gjendje siç -- në momentin që e keni gjetur?

23 PË. Pikërisht siç shihet këtu.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen
25 vijuese në të dy gjuhët.

1 PY. A e keni bërë edhe këtë fotografi ju?

2 PË. Po, gjatë ekzaminimit të tij nga zyrtari i jonë mjekësor,
3 oficeri mjekësor.

4 PY. Shihet këtu në këto fotografi një person që pamë në
5 fotografitë e mëparshme?

6 PË. Po.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen vijuese
8 në të dy gjuhët.

9 PY. I keni bërë ju këto fotografi? Edhe këto?

10 PË. Po.

11 PY. Kur?

12 PË. Pasi kisha bërë fotografitë e njeriut të vdekur dhe
13 personave të liruar.

14 PË. Çfarë shihet në këtë fotografi?

15 PË. Pranga që ishin përdorur për të lidhur njerëzit me tubat.
16 Fotografia më poshtë shihet një shkop druri.

17 PY. Shënimi që është në mes dy fotografive për çfarë e kishit
18 fjalën kur thonit që mjetet e torturës nuk kanë ndryshuar?

19 PË. Ky është ditari im, ditari im personal dhe këtë që kam
20 shkruar këtu, doja të thoja se MUP-i përpara që të largoheshin
21 si dhe personat që morën nën kontroll burgun pas tyre
22 domethënë UÇK-ja kishin -- kanë përdorur dhe kanë patur --
23 kanë përdorur të njëjtat mjete që kishin në dispozicion dhe
24 kanë përdorur të njëjtat instrumente.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për çështje
2 planifikimi mund të përfundojmë me temë brenda pesë minutave
3 në qoftë se kjo mund të lejohet, apo të vazhdoj nesër.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 vazhdoni.

6 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Trupin Gjykues, kërkoj ndjesë
7 por kam një kundërshtim sa i përket shkëmbimit të fundit që
8 ndodhi. Ne kemi -- dëshmitari ka thënë që se të njëjtat mjete
9 ishin përdorur nga MUP-i më parë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cili është
11 kundërshtimi?

12 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Se kundërshtimi është se nuk ka
13 bazë për përgjigjen e dëshmitarit dhe mendoj që kjo duhet të
14 trajtohet edhe më tej, ku është baza që ai arrin në
15 përfundimin që këto janë të UÇK-së dhe jo të MUP-it sepse kjo
16 ishte ndërtesë e MUP-it deri pak ditësh përpara që kjo të
17 ndodhte.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
19 jua j rrëzohet. Mund ta trajtoni këtë çështje kur t'ju vijë
20 radha për të bërë pyetjet nëse dëshironi.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

22 Tani në qoftë se mund të vazhdojmë në faqet në vijim deri
23 në faqen 071189 në gjermanisht, në origjinal dhe kalojmë në
24 faqen tjetër pak më poshtë dhe në faqen vijuese.

25 PY. Zotëri, këto pesë fotografi të fundit i keni bërë ju?

1 PY. Po.

2 PY. Kur i keni bërë këto?

3 PË. Pasditen e 18 qershorit.

4 PY. Gjatë të njëjtës ndërhyrje që u përshkrua më herët?

5 PË. Po.

6 PY. A mund të përshkruani atë që shihet çfarë shihet në këtë
7 fotografi? Në këto fotografi?

8 PË. Ajo që shihet këtu janë armë, municione dhe pajisje të
9 ish-Ushtrisë Jugosllave apo forcave të sigurisë. Të gjitha
10 këto i kemi gjetur në ndërtesën e MUP-it dhe i kemi hequr nga
11 aty, larguar.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja
14 që të dorëzoja si provë faqet 071180 deri në 071189 në
15 anglisht dhe gjermanisht.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
17 kundërshtim?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 071180 deri
21 në 071189 pranohet.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhe numri i provës
23 materiale që do t'i jepet 1194.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Duhet të mbetet konfidencial.

1 Doja të ndalojmë këtu për sot dhe të vazhdoj nesër.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, e
3 di që për sot dhatë pak dëshmi për një kohë të shkurtër.
4 Filluam që të mos humbisnim kohë. Do të ndërpritet seanca për
5 sot dhe do të rivazhdojmë nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

6 Ju falënderojmë për praninë tuaj deri tani. Ju kujtoj që
7 nuk duhet të flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj, me
8 askënd jashtë sallës së gjyqit.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
12 mbyllet deri nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

13 --- Seanca mbyllet në orën 16.34

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25